



REPUBLIKA E KANDAHARIT



“REPUBLIKA E KANDAHARIT”

Hulumtim mbi mënyrën se si një material me prejardhje të paverifikuar mund të përdoret për ta zhvendosur dyshimin nga një operacion i mundshëm i shërbimeve të inteligjencës te një bashkësi e tërë fetare.



Objekti i analizës	Fotografia “Top Secret 2” dhe jeta e saj publike
Periudha	1 gusht 2018 – 27 gusht 2026
Qëllimi i raportit	Verifikim burimor dhe analizë e evidencës digjitale
Metodologjia	OSINT / Gjenealogji burimore / Analizë studimore
Data e publikimit	3 shtator 2026
Statusi i raportit	Raport i pavarur me interes për publikun dhe pa mandat nga palë të treta
Autori i raportit	Ing. Besart Kuleta
Profili profesional	Technical Lead / Senior Software Engineer
Puna e realizuar	Mbledhje, pastrim, përpunim dhe analizë e të dhënave; hartim i raportit



Përmbajtja

Rruga e leximit ndjek jetën e objektit, regjistrat dhe burimet janë në Pjesën II - Libri i provave.

#	Kapitulli
	PJESA I · RAPORTI NARRATIV
1	Gjetjet kryesore
2	Pyetja, metodologjia dhe kufijtë
3	Dokumenti para interpretimit
4	Hyrja në debat para gushtit 2018
5	Vala e parë: 1-2 gusht 2018
6	Nga shtatori te dhjetori 2018
7	Riciklimet 2020-2024
8	Nyja private dhe Vala e Fundit
9	Çka ndryshoi në secilin transmetim
10	Si u rrit autoriteti pa u plotësuar prejardhja
11	Çka ishte temë kur fotografia rikthehej
12	Audienca, emocioni dhe kohezioni shoqëror
13	Pse duket "profetik"
14	Hipotezat, testet dhe kufijtë
15	Përfundimi
	PJESA II · LIBRI I PROVAVE
A	Rregulli i evidencës dhe integriteti
B	Artefakti dhe kopjet
C	Transkriptimi dhe përkthimi literal
D	Regjistri i ndryshimeve sipas transmetimit
E	Regjistri i plotë i 105 nyjeve
F	Kontroli negativ
G	Auditimi titull-trup-artefakt
H	Referencat kryesore të auditueshme
I	Regjistri i plotë i referencave
J	Kufizimet dhe kërkimi negativ

Shënim editorial

PYETJA QENDRORE E HULUMTIMIT

Si arriti një fotografi me prejardhje të panjohur të fitojë autoritetin e një dokumenti të inteligjencës, dhe si u përdor më pas për ta interpretuar praninë dhe praktikat islame në Kosovë si pjesë të një plani të pretenduar serb?

Raporti ndjek gjurmën e fotografisë, jo një tezë të paracaktuar. Për këtë arsye, objekti trajtohet veçmas nga interpretimet e tij; ajo që është thënë ndahet nga ajo që mund të provohet, posedimi nga krijimi, ndërsa numri i publikimeve nuk ngatërrohet me numrin e burimeve të pavarura. Pjesa që lidhet me Fatmir Shehollin mbështetet vetëm në atë që pretendohet në aktakuzë dhe në provat e administruara në procedurë. Ky raport **nuk merr përsipër** të përcaktojë fajësinë apo pafajësinë e tij penale.

Në raport përdoren termat *fotografi*, *artefakt* dhe *dokument* sipas kontekstit. *Fotografi* i referohet imazhit konkret që qarkullon publikisht; *artefakt* përdoret kur trajtohet si objekt digjital që duhet ekzaminuar për prejardhje, formë dhe histori qarkullimi; ndërsa *dokument* përdoret kur përshkruhet mënyra se si është paraqitur, interpretuar ose trajtuar publikisht nga bartësit e tij.

FJALIA QË E PËRMBLEDH RAPORTIN

Fotografia nuk fitoi statusin e dokumentit sepse iu identifikua burimi. E fitoi sepse, me kalimin e kohës, autoriteti i bartësve u bë më i fortë se zinxhiri i prejardhjes; dhe bashkë me të u zgjerua edhe efekti: nga një pretendim për operacion inteligjent, në një narrativë që vendoste nën dyshim një komunitet fetar.

1. Gjetjet kryesore

1. Deri në këtë fazë nuk është gjetur skedari burimor në Word ose PDF. Nuk është identifikuar as autori, data e krijimit, institucioni që mund ta ketë lëshuar, numri i protokollit, marrësi, nënshkrimi apo lista e shpërndarjes.
2. Fotografia ka qenë publike së paku më 1-2 gusht 2018. Botapress është nyja më e hershme mediale që është rikuperuar, por edhe vetë teksti i Botapress-it thotë se materiali po qarkullonte në rrjete sociale. Pra, Botapress mund të dokumentohet si publikues i hershëm, jo si burim apo krijues i fotografisë. [R007-R011]
3. Selatin Retkoceri publikoi fotografinë bashkë me përkthimin dhe komentimin e tij. Në tekst ai e lidhi materialin me UDB/BIA-n dhe shprehu bindjen se skenari i përshkruar aty ishte real. UlpianaPress e ripublikoi tekstin e tij. Nuk mund të përcaktohet me siguri se cili publikim doli i pari, për shkak të konfliktit mes të dhënave kohore të ruajtura. [R009-R010]
4. Dyshimet për autenticitetin nuk lindën vite më vonë. Po atë ditë kur materiali po shpërndahej, Isuf B. Bajrami dhe Bardhyl Mahmuti e kundërshtuan publikisht. Kjo do të thotë se kontestimi i fotografisë/dokumentit është pjesë e historisë së tij që nga dalja e parë e njohur. [R016, R018, R021]
5. Më 22 shtator 2018, Ali Ramadan Asllani e publikoi fotografinë bashkë me imazhe të xhamive dhe pyetjen "Cila është feja e Shqiptarëve?". Nuk u gjet një valë e re mediale në atë periudhë, por ky publikim tregon se fotografia vazhdonte të qarkullonte në llogari individuale. [R022]
6. Më 1 nëntor 2018, Bota Sot e riktheu materialin, kësaj here përmes një "ish-zyrtari të lartë". Publikimi nuk e shpjegonte historinë e gushtit dhe përdorte një përkthim tjetër. Këtu shihet shkëputja

më e qartë nga prejardhja e mëhershme publike: fotografia paraqitet pothuajse sikur po hynte për herë të parë në qarkullim. [R023]

7. Më 7 dhjetor 2018, Jakup Krasniqi e cilësoi materialin "tejet të besueshëm" dhe tha se lidhej me një shërbim të huaj me ndikim botëror. Nuk u bë publik emri i shërbimit, kontakti që e kishte siguruar, data e marrjes apo mënyra se si ishte verifikuar autenticiteti. [R036]

8. Në vitin 2023 iu shtua edhe pretendimi për CIA-n dhe Qeverinë Haradinaj. Në vitin 2024 fotografia u përdor në debat televiziv për të argumentuar rreth financimit të xhamive konkrete. Asnjëra nga këto dy degë të historisë nuk solli skedarin burimor apo ndonjë element të ri që do ta identifikonte origjinën e fotografisë. [R050, R053-R054]


9. Sipas aktakuzës, Fatmir Sheholli ia dërgoi një kopje të materialit kontaktit "Viktor Makedonija" më 5 gusht 2025. Kjo ka rëndësi për të dokumentuar posedimin dhe transmetimin e fotografisë në atë datë. Nuk tregon kur është krijuar materiali dhe as kush e ka krijuar. [R060-R061]

10. Më 25 gusht 2026, KALLXO, në orën 14:36, është nyja e parë e rikuperuar ku vetë fotografia trajtohet si bosht i veçantë i lajmit. Brenda disa orëve, rezervat procedurale që ekzistojnë në raportimin fillestar u zbehën në publikimet pasuese, ndërsa fotografia nisi të paraqitej gjithnjë e më drejtpërdrejt si një plan i zbuluar. [R064-R074]

11. Edhe forma e vetë fotografisë shfaqti probleme. Shënimi "Top Secret 2" dhe watermark-u "CONFIDENTIAL" nuk përfaqësojnë të njëjtin nivel klasifikimi sipas standardit serb. Në fotografi mungojnë gjithashtu organi lëshues dhe elemente të tjera që zakonisht lidhen me administrimin formal të një dokumenti të klasifikuar. [R166-R167]

12. Analiza gjuhësore evidenton ndërtime jo standarde, gabime dhe përzierje mes ekavishtes dhe ijekavishtes. Këto elemente nuk tregojnë se kush e ka shkruar tekstin, por e bëjnë më të dobët hipotezën se kemi të bëjmë me një dokument formal të redaktuar me kujdes.

13. Ka raste kur temat që përmban fotografia përkojnë me temat që dominonin lajmet në momentin kur ajo rikthehej në publik. Kjo përputhje është reale si vëzhgim editorial. Megjithatë, kontrolli negativ tregon se të njëjtat tema shfaqen edhe në periudha kur fotografia nuk po qarkullonte. Për këtë arsye, përputhja tematike nuk trajtohet si provë e koordinimit.



Autoriteti i bartësit u rrit ndërsa identifikuesit e fotografisë jo.

2. Pyetja, metodologjia dhe kufijtë

2.1 Pyetja që udhëheq gjurmimin

Pyetja e këtij gjurmimi është e kufizuar qëllimisht:

Cila është paraqitja më e hershme online që mund të verifikohet për artefaktin “Top Secret 2”, si ndryshoi atribrimi i tij nga viti 2018 deri më 2026 dhe çfarë provash të reja u shtuan gjatë kësaj periudhe?

Raporti nuk nis nga pyetja “kush e bëri propagandën?”, sepse një formulim i tillë do ta merrte të mirëqenë si autorin, ashtu edhe qëllimin.

Nuk kufizohet as te pyetja “a është i vërtetë?”. Këto janë dy çështje të ndryshme. Një dokument autentik mund të përdoret në mënyrë manipuluese. Po ashtu, një material i fabrikuar mund të shpërndahet nga njerëz që janë të bindur se është i vërtetë. Për këtë arsye, raporti i trajton veçmas fotografinë si objekt, narrativën që është ndërtuar rreth saj, prejardhjen që i është atribuar, mënyrën si është shpërndarë dhe kontekstin penal që iu shtua më vonë.

2.2 Gjurmimi i fotografisë

Për të rindërtuar historinë e saj publike u përdorën disa lloje gjurmësh.

- Faza të sakta në serbisht dhe shqip, tituj të plotë dhe gabime karakteristike u përdorën për të gjetur kopje dhe ripublikime.
- U krahasuan `datePublished`, `dateModified`, `Open Graph`, `JSON-LD`, URL-të kanonike dhe ID-të e postimeve. Këto të dhëna mund të ndihmojnë në datimin e një fotografie ose postimi, por jo në datimin e krijimit të vetë fotografisë.
- Epoch dhe offset kohore u normalizuan në UTC, CET dhe CEST. Kur të dhënat binin ndesh me njëra-tjetrën, konflikti nuk u “zgjidh” me hamendje, por u ruajt si i tillë.
- Hyperlink-et, rendi i paragrafëve, frazat identike dhe gabimet e përbashkëta u përdorën për të kuptuar se cili publikim duket se ka kopjuar nga cili.
- Kopjet vizuale u krahasuan sipas dimensioneve, prerjes së figurës, rendit të rreshtave dhe SHA-256. Një hash i ndryshëm nuk do të thotë domosdoshmërisht se përmbajtja është ndryshe; edhe një kompresim ose crop i vogël e ndryshon hash-in.
- Forma e fotografisë u krahasua me ligjin dhe rregulloren serbe për shënimin e materialeve të klasifikuara. [R166-R167]
- Për secilën periudhë kur fotografia u rikthye në publik u kontrolluan 30 ditët paraprake, me vëmendje të veçantë te 14 ditët dhe 72 orët e fundit. Ky kontroll përdoret për të kuptuar kontekstin e momentit, jo për të provuar shkakësi.
- U mbajt edhe një regjistër i kërkimeve negative. Kur raporti thotë “nuk u gjet”, kjo do të thotë se gjurma nuk u rikuperua me burimet dhe metodat e përdorura. Nuk do të thotë se ajo nuk mund të ekzistojë diku tjetër.
- Formulimet e dyshimta u testuan kundrejt korpuseve publike të serbishtes bashkëkohore, në vend që të vlerësoheshin vetëm me gjykim. Devijimet u matën kundrejt normës së botuar drejtshkrimore dhe gramatikore, jo kundrejt përshtypjes. [R182-R186]

2.3 Si trajtohet përputhja me kontekstin kohor

Përputhja direkte përdoret kur, brenda 14 ditëve, lajmet e momentit dhe mënyra si paraqitet fotografia ndajnë të njëjtin aktor, të njëjtin term ose të njëjtin konflikt.

Përputhje e fortë tematike përdoret kur brenda 30 ditëve gjenden së paku dy lidhje tematike të dokumentuara, por pa një hallkë të drejtpërdrejtë mes lajmit dhe rikthimit të fotografisë.

Konteksti receptiv përdoret kur tema është qartazi e pranishme në debat, por provat nuk mjaftojnë për të pretenduar një lidhje më të fortë.

Në secilin rast kërkohen burime të datuara dhe të identifikueshme.

Për të parë nëse këto përputhje janë vërtetë të pazakonshme, u përdorën edhe tri data kontrolli në të cilat nuk njihet ndonjë rikthim i fotografisë. Datat nuk u zgjodhën sipas përmbajtjes, por mekanikisht: u mor e njëjta datë kalendarike një vit pas tri valëve të forta. Kur për atë ditë nuk kishte editorial nga UNMIK-u, u përdor editorial i radhës. U përzgjodh UNMIK si autoritet i jashtëm vëzhgues.

Rezultatet paraqiten në kapitullin 11 dhe në Pjesën II - Libri i provave.

Ky kontroll nuk matë ndikimin e mediave dhe nuk provon ndonjë koordinim të tyre. Ai bën një pyetje shumë më të thjeshtë: **a do të gjenim tema të ngjashme edhe në periudha kur fotografia nuk po rikthehej?**

DERI KU SHKOJNË PROVAT

Ky raport nuk synon të mohojë mundësinë që Serbia, institucionet e saj apo persona të lidhur me to të kenë përdorur ndikimin fetar ose përçarjet shoqërore si instrument politik. Po ashtu, nuk përjashton mundësinë që materiali "Top Secret 2" të jetë prodhuar, përdorur ose shpërndarë nga aktorë të tillë.

Për këtë arsye, përfundimi i këtij raporti është më i ngushtë: Nga provat publike të rikuperuara për periudhën 1 gusht 2018 - 27 gusht 2026, fotografia "Top Secret 2" nuk është autentikuar institucionalisht si dokument burimor i BIA-s apo i ndonjë institucioni tjetër të identifikuar; atribuimi i saj ndaj BIA-s mbështetet në rrethanat e posedimit, përcjelljes dhe provat e tjera të dosjes. Derisa prejardhja dhe autenticiteti mbeten të paprovuara, trajtimi i përmbajtjes si fakt rrezikon ta zhvendosë dyshimin nga një operacion i mundshëm shërbimeve të inteligjencës te një bashkësi e tërë fetare.

3. Dokumenti para interpretimit

Fotografia mban titullin "Top Secret 2". Teksti është në serbisht, me alfabet latin, ndërsa kopja që ka qarkulluar më së shumti përmbanë edhe watermark-un diagonal "CONFIDENTIAL".

Para se të hyhet te historia që është ndërtuar rreth saj, duhet parë vetë fotografia dhe ajo që mungon prej saj.

- emri ose stema e institucionit që e ka lëshuar
- data e hartimit dhe numri i protokollit
- autori, marrësi, nënshkrimi dhe lista e shpërndarjes
- numri i fotografisë ose ndonjë tregues se materiali është pjesë e një dokumenti më të madh
- skedari burimor dhe metadata që do të ndihmonin në përcaktimin e origjinës së tij

Ligji serb për të dhënat e klasifikuara njih katër nivele: "DRŽAVNA TAJNA", "STROGO POVERLJIVO", "POVERLJIVO" dhe "INTERNO". Ekuivalentët e tyre në anglisht janë TOP SECRET, SECRET, CONFIDENTIAL dhe RESTRICTED.

Pikërisht këtu shfaqet një problem i dukshëm në vetë dokumentin. Nëse "Top Secret 2" dhe watermark-u "CONFIDENTIAL" synojnë të tregojnë nivelin e klasifikimit, atëherë ato nuk përputhen me njëra-tjetrën. Rregullorja serbe parashikon gjithashtu të dhëna për organin që e administron materialin, datën, kopjen dhe elemente të tjera të evidentimit, të cilat nuk shihen në fotografinë publike. [R166-R167]

Edhe teksti ka veçoritë e veta. Ai kalon mes synimeve, udhëzimeve dhe parashikimeve, kryesisht në vetën e parë shumës. Vetëm nga forma nuk mund të përcaktohet se çfarë ka qenë fillimisht kjo fotografi: dokument pune, tekst i përkthyer, material propagandistik apo një kopje që ka humbur pjesë të kontekstit të saj gjatë qarkullimit.

Gjuha ngre një problem tjetër. Në tekst gjenden forma si “amabsada”, mungojnë diakritikat dhe haset përzjerje mes ekavishtes dhe ijekavishtes. Këto janë elemente që vështirë pajtohen me idenë e një dokument formal të përgatitur dhe redaktuar me kujdes.

Por ato nuk tregojnë kush e ka shkruar. Pra, vetë fotografia jep arsye për ta vënë në pikëpyetje formën e saj si dokument zyrtar; nuk jep ende bazë për t’ia atribuar autorësinë një personi apo institucioni të caktuar.

MUTACIONI I PARË I MADH Në artefakt shkruhet: “Za 20 godina deo Kosmeta ... kao Kandahar” pra, “një pjesë e Kosovës” do të duket si Kandahar.

Në titujt e mëvonshëm ndodhin dy ndryshime njëherësh: “një pjesë” bëhet “e gjithë Kosova”, ndërsa një parashikim për të ardhmen shndërrohet në një plan veprimi: “Kosovën duhet ta bëjmë si Kandaharin”. Kështu, formulimi origjinal jo vetëm zgjerohet, por edhe ndryshon funksion: nga përshkrim i asaj që mund të ndodhë, në pohim për atë që dikush synon të bëjë.

3.1 Anatomia e fotografisë

Kopja që ka qarkulluar publikisht përbëhet nga një fotografi e vetme. Lart majtas qëndron titulli i vogël “Top Secret 2”, ndërsa mbi tekst kalon diagonalisht watermark-u “CONFIDENTIAL”.

Përtej këtyre dy shenjave, fotografia nuk jep pothuajse asnjë të dhënë që do ta lidhte me një institucion konkret. Nuk shihet stemë, logo, header institucional, adresim, numër protokoll, numër kopjeje, numër fotografie, autor, marrës apo nënshkrim. Edhe nëse supozohet se kjo është vetëm një fotografi e shkëputur nga një dosje më e madhe, identifikuesit që mungojnë nuk mund të rindërtohen nga materiali që është bërë publik.

KATËR NIVELET ZYRTARE



DRŽAVNA TAJNA
TOP SECRET



STROGO POVERLJIVO
SECRET



POVERLJIVO
CONFIDENTIAL



INTERNO
RESTRICTED

SISTEMI ZYRTAR KËRKON

- 1 Shenja e një niveli klasifikimi**
e vendosur dukshëm dhe në pozicion të parashikuar
- 2 Organi publik / lëshuesi**
dhe personi i autorizuar
- 3 Data e klasifikimit**
menyra e mbarimit të sekretit dhe baza
- 4 Numërim faqesh**
faqja X nga Y; për nivelet e larta edhe numri i kopjeve
- 5 Administrim i kopjes**
“KOPIJA ORIGINALA”, numër kopjeje, regjistër, datë, njesi, nënshkrim
- 6 Vendim dhe vlerësim dëmi**
të lidhura me caktimin e nivelit

KOPJA PUBLIKE TREGON

- 1 Dy etiketa të ndryshme**
“Top Secret Z” + watermark “CONFIDENTIAL”
- 2 Asnjë lëshues i dukshëm**
as person i autorizuar
- 3 Pa datë ose protokoll**
pa menyre deklasifikimi
- 4 Pa numër faqeje**
pa numër kopjeje ose marrës
- 5 Paragrafë narrative**
pa subjekt institucional, adresim, rekomandim ose nënshkrim
- 6 Vetëm një fotografi publike**
originali dhe konteksti i prerjes mbeten të panjohur

Teksti është shkruar kryesisht në vetën e parë shumë: “operativët tanë”, “njerëzit tanë”, “ambasadat tona”. Por askund nuk thuhet kush është kjo “ne”.

Në një dokument të brendshëm, kjo zakonisht do të kuptohej nga konteksti: header-i, njësia, marrësi, dosja ose zinxhiri administrativ. Në këtë fotografi, ai kontekst mungon. Për pasojë, përdorimi i përemrit krijon përshtypjen e një komunikimi të brendshëm, por nuk identifikon institucionin që pretendohet se flet.

3.2 Çka kërkon sistemi zyrtar serb

Ligji serb e trajton sekretin si status formal, jo vetëm si një shënim mbi dokument. Neni 13 kërkon që dokumenti të lidhet me një organ publik, një person të autorizuar, një nivel të caktuar sekretësie dhe një mënyrë për përfundimin e saj. Nenet 14-15 përcaktojnë nivelet e klasifikimit dhe ekuivalentët anglisht: TOP SECRET i përgjigjet DRŽAVNA TAJNA, ndërsa CONFIDENTIAL i përgjigjet POVERLJIVO. Pra, nuk janë dy emërtime për të njëjtin nivel. [R166]

Rregullorja kërkon që dokumentet e klasifikuara të kenë shenja të dukshme dhe të gjurmueshme: organin, personin e autorizuar, datën, mënyrën e dorëzimit dhe, për nivelet më të larta, edhe numrin e kopjeve, numrin total të faqeve dhe shtojcat. Edhe kopjet duhet të mbajnë të dhëna që tregojnë prejardhjen dhe trajtimin administrativ të tyre. [R167]

Udhëzuesi zyrtar i vitit 2026 dhe formularët model e tregojnë të njëjtën logjikë në praktikë: një dokument i klasifikuar nuk identifikohet vetëm nga fjala “secret”, por nga një zinxhir shenjash që e lidhin me institucionin dhe procedurën përkatëse. Kjo nuk do të thotë se çdo shënim operativ duhet të duket si formular zyrtar; por jep standardin kundrejt të cilit mund të testohet pretendimi se fotografia e publikuar është një dokument final i klasifikuar. [R177-R178]

Elementi zyrtar	Çka shihet në kopje	Leximi i mbrojtshëm
Një nivel klasifikimi	“Top Secret 2” + “CONFIDENTIAL”	Mospërputhje nëse të dyja synojnë klasifikimin.
Organi / lëshuesi	Nuk shihet	Prejardhja institucionale nuk mund të rindërtohet.
Personi i autorizuar	Nuk shihet	Mungon hallka që e lidh vendimin me organin.
Data / përfundimi i sekretit	Nuk shihen	Afati “20 vjet” nuk është datë klasifikimi.
Fotografia X nga Y / kopja	Nuk shihen	Nuk dihet nëse është fotografi e plotë, draft ose crop.
Protokolli / marrësi / dorëzimi	Nuk shihen	Zinxhiri administrativ mbetet bosh.
Struktura	Paragrafë narrativë pa header, subjekt dhe rekomandim	Më afër shënimit ose pamfletit sesa dokument administrativ final.

DERI KU SHKOJNË PROVAT

Alfabeti latin, në vetvete, nuk është anomali dhe përdorimi i anglishtes lejohet në kontekste të bashkëpunimit ndërkombëtar. Prandaj argumenti nuk është se dokumenti “nuk ngjanë serb”. Dyshimi lind nga kombinimi i elementeve: përdorimi i dy niveleve të ndryshme të klasifikimit, mungesa e identifikuesve bazë dhe një strukturë që nuk përputhet me atë që pritet nga një dokument formal i klasifikuar dhe i redaktuar.

3.3 Dekonstruktimi gjuhësor

Ky seksion nuk pretendon të identifikojë autorin dhe as gjuhën amtare të tij. Ai teston një pyetje më të ngushtë dhe të verifikueshme:

A i ngjan kopja e ruajtur një teksti institucional të redaktuar në mënyrë të njëtrajtshme, apo një teksti të paredaktuar, të ripunuar ose të prekur nga disa duar?

Kufiri është i qartë që në fillim: teksti serbisht ka rreth 450 fjalë. Kjo është nën pragun ku metodat sasiore të atributimit të autorësisë ose të identifikimit të gjuhës amtare konsiderohen të besueshme. Prandaj asnjë përfundim këtu nuk shkon tek identifikimi i personit. Brenda të njëjtit tekst përsëriten gabime drejtshkrimore e gramatikore, formulime jo të natyrshme, përzierje mes ekavishtes dhe ijekavishtes, si dhe fjali që kërkojnë "rregullim" për t'u kuptuar qartë. Një gabim i vetëm nuk tregon asgjë. Përsëritja e tyre në kategori të ndryshme brenda një teksti kaq të shkurtër e dobëson hipotezën se kemi të bëjmë me një dokument final, të redaktuar sipas një procedure institucionale. Metoda, korpuset e krahasimit dhe kufizimet janë në Pjesën II, seksioni C.6.

 1 ORTOGRAFI / REDAKTIM - ambasada gabim shtypi për "ambasada" - mungesë diakritikash e zakonshme online; jo shenjë zyrtare - Islamskih / Islam kapitalizimi i paqëndrueshëm	 2 MORFOLOGJI / PAJTIM - deca i mladih mospajtim në rasë - najbogati i najmocnih siptari mospajtim mbiemër--emër - u tudju zemlju rasë e panatyrshme pas "zivel"
 3 SINTAKSË / KOLOKACION - na sto vidljiva mesta ndërtim parafjalor jo standard - džamije treba da se dvostruke... folje jo e rregullt; subjekti i paqartë - misljenje za siptare kolokacion i panatyrshëm	 4 KOHË / ASPEKT - deo Kosmeta izgleda ce... rend dhe kohë e çrregullt - Kad se to postize aspekt i papërshtatshëm për rezultat të ardhshëm
 5 PËRZIERJE DIALEKTORE - mesto / mesta / decia forma ekavishte - gdje / svugdje / Njemačke forma ijekavishte - në të njëjtën faqe regjistër i paunifikuar	 6 REGJISTËR / ZHANËR "njerëzit tanë", "operativët tanë" veta e parë shumës pa lëshues ose marrës - pretendime totale fe, politikë, media, sport, diasporë dhe shtete pa emra/burime/datate - Kandahar + dëbim kulm dramatik më afër pamfletit sesa memo-s administrative

DERI KU SHKOJNË PROVAT

Gabimet nuk e emërtojnë autorin, nuk e përcaktojnë gjuhën e tij amtare dhe nuk provojnë fabrikim. Ato tregojnë vetëm se forma e ruajtur nuk e mban vetë peshën e atributimit institucional. Sipas udhëzimeve ndërkombëtare për analizën gjuhësore, aftësia për të folur një gjuhë nuk është e njëjtë me kompetencën për ta analizuar atë, dhe analiza gjuhësore nuk duhet të jetë kurrë baza e vetme e një përfundimi. [R181]

3.4 Përzierja ekavishte-ijekavishte

Në të njëjtin dokument përdoren forma ekavishte si "mesto", "mestima" e "deca", por edhe ijekavishte si "gdje", "svugdje" dhe "Njemačke". Kjo mund të ndodhë në tekst joformal ose pas ndërhyrjeve të ndryshme, por në një dokument institucional final do të pritej një regjistër më i unifikuar.

3.5 Gabimet që lënë gjurmë

- "amabsada" është gabim i qartë shtypi dhe mund të shërbejë si fingerprint.
- "deca i mladih" ka mospërputhje gramatikore.
- "najbogati i najmocnih siptari" ka forma të papërputhshme.

- “na sto vidljiva mesta” është formulim jo natyral.
- “džamije treba da se dvostruke i trostruke” nuk është formulim standard.
- “deo Kosmeta izgleda ce kao Kandahar” ka rend të çrregullt.

Përkthimet shpesh i rregullojnë këto dhe e bëjnë tekstin të duket më i pastër se origjinali.

3.6 Cilit zhanër i afrohet?

Dokumenti nuk ka strukturën tipike të një produkti të redaktuar të inteligjencës: mungojnë burimet, niveli i besimit, përgjegjësit, afatet, buxhetet dhe indikatorët.

Përmbajtja kalon nga xhamitë e medresetë të partitë, diaspora, Perëndimi dhe “Kandahari”, pa detaje operative konkrete. Për nga forma, i afrohet më shumë një pamflet politik me zë institucional ose një shënimi joformal të redaktuar dobët. Mundësia e një materiali më të gjerë burimor mbetet e hapur, por kërkon prova shtesë.

PSE KA RËNDËSI NORMALIZIMI

Kur serbishtja rregullohet gjatë përkthimit, teksti bëhet më i pastër dhe **më institucional se origjinali**. Bashkë me gabimet humbin edhe paqartësitë, përzierjet gjuhësore dhe formulimet e pazakonta që janë vetë pjesë e provës. Regjistri i plotë i këtyre ndërhyrjeve gjendet në Pjesën II.

4. Konteksti kur u paraqit së pari në 2018

Fotografia hyri në një debat që veç ekzistonte. Që para gushtit 2018, në hapësirën publike flitej për islamizmin, ndikimin e huaj, identitetin kombëtar dhe raportin mes fesë e shtetit. RTS/Deutsche Welle kishte përdorur më 2016 titullin “Kosovo leglo islamizma?”, ndërsa në maj 2018 pati debat publik mes Bardhyl Mahmutit dhe teologëve Mustafa Bajrami e Muhamed Kajolli. Këto tregojnë terrenin tematik, jo praninë e vetë fotografisë. [R005-R006]

Në fund të korrikut 2018, Gjergj Dedaj i quajti Turqinë dhe Serbinë “shtrigat e Ballkanit”, ndërsa korrigjimi i kufirit dhe dialogu me Serbinë ishin në qendër të lajmeve. Më 2 gusht, ditën kur fotografia u përhap më gjerësisht, debati për territorin dhe ndarjen ishte ndër temat kryesore. [R133-R136, R172]

Ky kontekst shpjegon pse materiali mund të gjente publik të gatshëm për ta marrë seriozisht. Nuk tregon kush e krijoi dhe as që publikimi ishte i koordinuar.

5. Vala e parë: 1-2 gusht 2018

Gjurma më e hershme mediale e rikuperuar është Botapress Web, më 1 gusht 2018, me formulimin “TURQIA I JEP DRITEN E GJELBERT SERBISE”. Portali thoshte se e kishte siguruar materialin, por njëkohësisht pranonte se ai po shpërndahej në rrjete sociale. Kjo e bën Botapress-in një një të hershme të përhapjes, jo burim të provuar të krijimit. [R007-R008]

Më 2 gusht shfaqen disa degë. Selatin Retkoceri e paraqiti fotografinë si material që ka rrjedhur nga “njerëz të besuar të Serbisë” tek “patriotët shqipëtarë”. Poashtu tha se po qarkullonte prej muajsh dhe se besonte 100% në skenarin e paraqitur në dokument. Përkthimi i tij shton edhe shpjegime që nuk gjenden si identifikues në tekstin e fotografisë, përfshirë UDB-në dhe BIA-n. UlpianaPress publikoi të njëjtin tekst në vetën e parë. Rendi i saktë mes tyre nuk mund të përcaktohet me siguri nga vulat kohore publike që kemi. [R009-R010]

Fahri Xharra tha se faksimilen ia kishin dërguar “me qindra” persona nga Kosova, Maqedonia, Lugina e Preshevës dhe Shqipëria. Ai e zgjeroi interpretimin me “kolonën e pestë”, BIA-n dhe një kornizë më

të gjerë politike. Numri dhe pavarësia e këtyre dërguesve nuk mund të verifikohen nga postimi. [R015]

AL in Sweden e futi "Kandaharin" në titull, ndërsa VushtriaOnline e ripublikoi në 18:12 duke ia atribuar Botapress-it. Këto janë hallka të shpërndarjes, jo burime të reja që konfirmojnë origjinën. [R011-R013]

Po atë ditë u shfaq edhe skepticizmi. Isuf B. Bajrami e quajti materialin pamflet të dyshimtë dhe vuri në pah mungesën e autorit, datës, institucionit dhe gabimet në serbisht. Bardhyl Mahmuti tha se fotografinë ia kishin dërguar shumë persona privatisht, por e cilësoi joserioze dhe "sajesë". Pra dyshimi mbi autenticitetin ishte i pranishëm që në ditën e parë të përhapjes, jo vetëm vite më vonë. [R016, R018, R021]




Figura 4. Gjenealogjia e kujdeshme e valës së parë. Vijat e plota tregojnë kopjim/citim të mbështetur; vijat me pika tregojnë lidhje të pretenduara ose të paprovuara.

6. Nga shtatori te dhjetori 2018

6.1 Shpërndarje private: objekti mbeti në qarkullim

Më 22 shtator 2018, Ali Ramadan Asllani e publikoi fotografinë në rrjetin social facebook me përkthim, imazhe xhamish dhe pyetjen "Cila është feja e Shqiptarëve!!!???". Nuk u gjet një publikim medial paralel po atë ditë. Kjo tregon se, edhe jashtë valëve të portaleve, materiali vazhdonte të qarkullonte në llogari individuale. [R022]

6.2 Bota Sot: materiali merr burim të ri

Më 1 nëntor, Bota Sot e riktheu fotografinë si material të marrë nga një "ish-zyrtar i lartë i Kosovës". Emri i burimit, data e dorëzimit, formati, kanali i marrjes dhe skedari burimor nuk u publikuan. As historia e gushtit nuk u vendos në hyrje. Materiali i njëjtë u paraqit kështu me një burim anonim, por më autoritativ. [R023]

Përkthimi i Bota Sot-it krijon një degë më vete. Titulli "Për 20 vite është e jona" nuk gjendet në artefakt, ndërsa ripublikimet e 2-5 nëntorit ruajnë frazat dhe rendin e Bota Sot-it. Kjo tregon një zinxhir kopjimi, jo konfirmime të pavarura të origjinës. [R024-R030]

6.3 Jakup Krasniqi: autoritet politik mbi një burim të paidentifikuar

Më 7 dhjetor 2018, Jakup Krasniqi shkroi në editorialin e Koha se Serbia ushtron ndikim në Kosovë edhe përmes fesë. Materialin e paraqiti si të ardhur nga një shërbim i huaj me ndikim botëror dhe si "tejet të besueshëm", pa publikuar emrin e shërbimit, kanalin e marrjes, datën ose metodën e verifikimit. [R036]

Dy ditë më vonë, Lulzim Islami i Partisë FJALA kundërshtoi formën dhe gjuhën e materialit. Pra, edhe në këtë fazë, rritja e autoritetit të burimit shoqërohej paralelisht me dyshime mbi vetë dokumentin. [R038]

7. Riciklimet 2020-2024

Pas vitit 2018 dokumenti nuk u zhduk. Ajo u rikthye kur një pjesë e tij mund të lidhej me një konflikt të freskët. Kjo është arsyeja pse raporti i trajton rikthimet si valë, jo si prova të pavarura.

Data	Bartësi	Çka ndryshoi	Ref.
02.06.2020	Sahit Kandiç	Kundërkornizim: e trajtoi materialin si falsifikim/diskurs anti-mysliman.	R039
08-11.08.2020	DITA, Jehona, Albspirit, Dosja, Tema	Në tituj u ngritën "xhami në vende të dukshme", financimi dhe largimi i rinisë. Konflikti për Xhaminë Qendrore ishte i freskët.	R040-R044 , R144-R146
11.09.2021	Koha Jonë	Kandahari rikthehet pak javë pas marrjes së Kabulit dhe pranimit të afganëve në Kosovë.	R045, R147-R149
08-20.08.2022	disa portale	Titujt alternojnë "Kandaharin" me xhamitë; në të njëjtën periudhë kishte barrikada në veri dhe përvjetor të marrjes së Afganistanit.	R150-R151
24.03.2023	Lirim Gashi	Shtohet prejardhja e re: "Qeveria Haradinaj e ka siguruar nga CIA amerikane". Nuk publikohet dokument deklasifikimi.	R050, R152-R154
27.06-09.07.2024	Milazim Gashi / Dukagjini	Akuza për xhami konkrete dhe përdorimi televiziv i "Top Secret 2" si plan i shërbimit serb.	R053-R059 , R155-R156

Në 2024 ndodh një zhvendosje me rëndësi: pyetja publike kalon nga "a është ky dokument autentik?" te "kush e financoi këtë xhami?". Myftiu Naim Tërnavë kërkoj prova dhe paralajmëroi padi; Gëzim Kelmendi dhe imami Fadil Musliu i kundërshtuan akuzat. Objekti filloi të funksiononte si rekuizitë brenda një debati konkret, jo vetëm si temë historike. [R155-R156]

8. Nyja private dhe Vala e Fundit

8.1 Çka shton dosja Sheholli

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale, një kopje e "Top Secret 2" ishte në telefonin e Fatmir Shehollit dhe më 5 gusht 2025 iu dërgua kontaktit të përshkruar si "Viktor Makedonija". Nëse evidenca pranohet, ajo dokumenton posedim dhe transmetim në atë datë. Nuk jep autorin e fotografisë, datën e krijimit, institucionin lëshues ose zinxhirin para gushtit 2018. [R060-R061]

Kronologjia është e rëndësishme sepse fotografia ishte publike vite më herët dhe ishte shfaqur në televizion më 2024. Gjetja në telefon nuk mund ta bëjë retroaktivisht skedarin e vitit 2018 dokument të BIA-s pa një hallkë tjetër prove.


8.2 Orët e para të 25 gushtit 2026

Ora	Nyja	Çka ndodh	Ref.
09:11	KOHA	Njofton aktakuzën; fotografia ende nuk është bosht i veçantë.	R062
09:31	KALLXO	Njofton aktakuzën.	R063
14:36	KALLXO	Publikimi i parë dokument-specifik i rikuperuar me minutë; titulli ruan "pretendohet se iu gjet".	R064
14:44	Lajmi.net	E lidh shprehimisht me KALLXO-n.	R065
15:18	Periskopi	"Kandahari" ngrihet në titull.	R066
16:45-17:23	rrjet portalesh + KOHA	Fjalori zgjerohet drejt "planit", "radikalizimit", "fondeve për xhami" dhe formulimeve që tingëllojnë si zbulim.	R067-R074

Këtu shihet mutacioni më i shpejtë në gjithë historinë e objektit. Burimi procedural është aktakuza dhe formulimi i kujdesshëm "pretendohet se iu gjet". Pas disa orësh, titujt e mëvonshëm e trajtojnë të njëjtën fotografi si plan të zbuluar. Evidenca e re ishte lidhja me një telefon dhe një transmetim të pretenduar; autori dhe origjina e materialit mbetën të panjohur.

9. Çka ndryshoi në secilin transmetim

Një transmetim nuk trajtohet si kopje neutrale vetëm sepse përdor të njëjtën fotografi. Për secilën një krahasohen data, ora, gjuha, titulli, prejardhja e deklaruar, teksti i trupit dhe fotografia serbisht. Kur një fjalë shtohet, hiqet, normalizohet ose zgjerohet, ndryshimi evidentohet. Motivi nuk i atribuohet publikuesit pa provë.



RREGULLI I SHKRIMIT

Personi ose mediumi hyn në tekst si ngjarje botimi: datë, orë, titull, formulim dhe URL. Vlerësimi i bashkëngjitet trajektorës së objektit: çka u shtua, çka u hoq dhe çka nuk u provua.

9.1 Vala e parë: shtesat që hynë më 1-2 gusht 2018

Data / ora	Publikimi	Titulli / forma	Ndryshimi i verifikueshëm	Ref.
1/2.08.2018 · ora e pazgjidhur	Botapress Web / shqip	"TURQIA I JEP DRITEN E GJELBERT SERBISE"	Materiali paraqitet si i siguruar nga portali dhe njëkohësisht si objekt që po qarkullonte; titulli vendos Turqinë dhe Serbinë në marrëdhënie bashkëpunimi.	R007-R008

Data / ora	Publikimi	Titulli / forma	Ndryshimi i verifikueshëm	Ref.
2.08.2018 · 10:19 e dukshme / konflikt offset-i	UlpianaPress / shqip	"Topsekret Serbo/Turk për spastrimin etnik të shqipëtarve"	Pasqyron tekstin në vetën e parë të Selatin Retkocerit; "spastrimi etnik" hyn në titull, ndonëse kjo shprehje nuk gjendet në fotografin serbisht.	R009-R010
2.08.2018 · 10:45:23 CEST	Selatin Retkoceri / shqip	Përkthim i gjatë me komentim	Te "naši ljudi" shtohet "të UDB-së dhe BIA-s"; "Rome i Cigane" bëhet "Romët dhe Hashkalinjtë"; shtohen "shtëpi luksoze, transport komod dhe modern".	R010
2.08.2018 · ora e pazgjidhur	AL in Sweden / shqip + imazh serbisht	"Kosovën duhet ta bëjmë si Kandaharin"	"Një pjesë e Kosmetit do të duket" zgjerohet në gjithë Kosovën dhe parashikimi kthehet në urdhër.	R012-R013
2.08.2018 · ora e pazgjidhur	Fahri Xharra / shqip	"Dokumenti TOP SECRET serb që sqaron financimin e Islamit"	Në tekst hyjnë BIA, "kolona e pestë" dhe lidhje historike; nuk është përkthim rresht për rresht. Pretendimi "me qindra" dërgues nuk shoqërohet me mostra të auditueshme.	R015
2.08.2018 · 18:12 CEST	VushtriaOnline / shqip	"Ja plani serb për islamizimin... dhe dëbimin..."	E atribuon materialin të Botapress; "plan", "islamizim" dhe "dëbim" vendosen në titull si përmbledhje kategorike.	R011
2.08.2018 · ora e pazgjidhur	VOAL / Isuf B. Bajrami / shqip	"Lufta speciale... përmes pamfleteve anonime"	Në të njëjtën valë shfaqet kundërleximi: mungesa e autorit, datës, institucionit dhe gabimet serbisht vendosen në qendër.	R016
2.08.2018 · ora e pazgjidhur	Bardhyl Mahmuti / shqip	Reagim publik kritik	Objekti quhet "sajesë" joserioze për shkak të gabimeve. Screenshot-i ruan datën e dukshme; URL-ja dhe ora server-side mungojnë.	R018/R021

9.2 Shtatori-dhjetori 2018: prejardhja ndryshon

Data / ora	Publikimi	Titulli / forma	Ndryshimi i verifikueshëm	Ref.
22.09.2018 · 23:04:33 CEST	Llogari individuale / shqip	Përkthim + tri imazhe xhamish + "Cila është feja e Shqiptarëve?"	Fotografia lidhet vizualisht me xhami konkrete pa provë se ato lidhen me fotografine. Objekti mbetet publik ndërmjet valëve mediale.	R022
01.11.2018 · 16:59 CET	Bota Sot / shqip	"Dokumenti Top sekret... Për 20 vite është e jona..."	Hyn burimi i ri "ish-zyrtar i lartë"; përdoret përkthim i ri; "Për 20 vite është e jona" nuk gjendet në artefakt; historia e gushtit nuk vendoset në hyrje.	R023
01-05.11.2018	Rrugëtim, Syri, Telegraf, 55 News, AL in Sweden, Forum-Al	Ripublikime të degës Bota Sot	Rendi i paragrafëve dhe formulime të pazakonta ruhen. Numri i mediave rritet; burimi i pavarur nuk rritet.	R024-R030
07.12.2018 · 11:21 CET	KOHA / shkrim i Jakup Krasniqit / shqip	"Ndikimin... Serbia... edhe përmes fesë"	Materiali quhet "tejet i besueshëm" dhe lidhet me shërbim të huaj me ndikim botëror; shërbimi, kontakti, data dhe metoda nuk publikohen.	R036

9.3 Riciklimet 2020-2024: fragmenti ndryshon me konfliktin

Data	Publikimi / gjuha	Çka ndryshoi	Ref.
02.06.2020	Bosnjaci.net / boshnjakisht-serbisht	Objekti trajtohet si falsifikim dhe si diskurs anti-mysliman.	R039
08-11.08.2020	DITA, Jehona, Albspirit, Dosja, Tema / shqip	Titujt nxjerrin "xhami në vende të dukshme", "mercenarët" dhe largimin e rinisë; prejardhja mbetet dega e vitit 2018.	R040 -R044
11.09.2021	Koha Jonë / shqip	Kandahari bëhet elementi kryesor; provë e re për autorin nuk shtohet.	R045
08-20.08.2022	Dardania Press, Tetova1, Lajmpress, Dosja.mk / shqip	Një titull kthen parashikimin në urdhër; të tjerët zgjedhin xhamitë e dukshme.	R046 -R049
24.03.2023 · 22:37:09 CET	Llogari individuale / shqip	Hyn pretendimi "Qeveria Haradinaj e ka siguruar nga CIA amerikane"; nuk publikohet dokument CIA ose regjistër qeveritar.	R050
27.06-09.07.2024	Dukagjini dhe kopjet pasuese / shqip	Fotografia përdoret për akuza ndaj xhamive konkrete; objekti kalon nga debat për autenticitet të pretendim për financues konkret.	R053 -R059

9.4 Vala e Fundit: titulli, trupi dhe artefakti

Në Valën e Fundit nuk mjafton të numërohen artikujt. Duhet krahasuar çka premtoi titulli, çka tha trupi dhe çka gjendet në tekstin e fotografisë në serbisht. Njësia e analizës është publikimi i datuar, jo një etiketë mbi personin ose redaksinë.

Sa më larg nga faqja serbisht, aq më shumë hyjnë interpretimi procedural, konteksti penal dhe fjalori i ri.




Figura 6. Titulli, trupi i artikullit dhe artefakti duhet të mbahen të ndara.

Data / mediumi	25.08.2026 · 14:36 CEST - KALLXO
Titulli	"Dokumenti 'TOP SEKRET' për destabilizimin e Kosovës që pretendohet se iu gjet Fatmir Shehollit në telefon"
Trupi i artikullit	Hyrja përdor "zgjerimi i ndikimit të radikalizimit islamik" dhe "destabilizimi"; më tej përdoren "shtet i radikalizuar dhe ekstremist", "qendra tregtare" dhe "Kosova do të duket si Kandahar". Pas përkthimit, artikulli lidhet me raste të tjera të BIA-s, vëhëzimit dhe ISIS-it.

Data / mediumi	25.08.2026 · 14:36 CEST - KALLXO
Artefakti thotë	Fotografia nuk përdor "radikalizim", "ekstremist", "destabilizim", "vehabi" ose "ISIS". Ka "gradskih centara" - qendra qytetesh - dhe "deo Kosmeta" - një pjesë e Kosmetit.
Ndryshimi i verifikueshëm	Interpretimi i Prokurorisë dhe fjalori i artikullit vendosen para tekstit; "qendra qytetesh" bëhet "qendra tregtare"; "një pjesë" bëhet "Kosova"; konteksti i rasteve të tjera të spiunazhit ngjitet pas objektit.
Teknika e evidentuar	Zëvendësim interpretues; zgjerim i shtrirjes; përkthim semantikisht i pasaktë; asociim përmes afërsisë. Titulli, megjithatë, ruan rezervën "pretendohet se iu gjet".
Referenca	[R064]

Data / mediumi	25.08.2026 · 17:23 CEST: KOHA
Titulli	"Dokumenti i gjetur në telefonin e Shehollit, synimi i Serbisë për zbrazjen e Kosovës përmes radikalizimit islamik"
Trupi i artikullit	Trupi thotë se fotografia "synim ka zgjerimin e ndikimit të radikalizimit islamik"; përmend "qendra tregtare" dhe e paraqet si plan për Kosovën. I njëjti paketim u botua njëkohësisht në shqip, anglisht, turqisht, greqisht, maqedonisht dhe gjermanisht.
Artefakti thotë	Fotografia flet për përhapjen e Islamit, largimin e një pjese të rinisë dhe kthimin e një pjese nga feja; nuk përdor "radikalizim" ose "zbrazje të Kosovës". "Deo Kosmeta" nuk është e gjithë Kosova.
Ndryshimi i verifikueshëm	Një varg i gjerë pretendimesh ngjeshet në një zinxhir shkakor: radikalizim → zbrazje → synim i Serbisë. Rezerva procedurale është më e dobët se te KALLXO. Gjashtë gjuhë janë një burim editorial, jo gjashtë konfirmime.
Teknika e evidentuar	Kompresim shkakor; totalizim; atribuum i drejtpërdrejtë i qëllimit; shumëzim ndërgjuhësor.
Referenca	[R074-R079]

Data / mediumi	25.08.2026 · ora e parikuperuar: Telegrafi - dosja e plotë
Titulli	"Lidhjet me BIA-n serbe, materialet sekrete e 'Kosova si Kandahar' - dosja e plotë ndaj Fatmir Shehollit"
Trupi i artikullit	Te pjesa "Top Secret 2" përdoret formula "sipas interpretimit të Prokurorisë" dhe thuhet se synohet perceptimi i Kosovës si vend i radikalizuar fetarisht. Objekti vendoset pranë përgjimeve, pagesave, dokumentit "Leptiri" dhe provave të tjera.
Artefakti thotë	Fotografia nuk emërton BIA-n si lëshues dhe nuk përdor "radikalizuar fetarisht". Ajo flet për kontroll të pretenduar mbi rrjete dhe për ndryshim të mendimit të Perëndimit.
Ndryshimi i verifikueshëm	Atribuimi procedural ruhet më mirë se në disa tituj të tjerë. Megjithatë, afërsia me materialet e tjera të dosjes i transferon fotografisë autoritetin e një korpusi më të gjerë provash.
Teknika e evidentuar	Transferim autoriteti nga afërsia; përmbledhje interpretative; zgjerim "një pjesë" → "Kosova".
Referenca	[R091]

Data / mediumi	25.08.2026 · ora e parikuperuar: Telegrafi - artikulli i veçantë
Titulli	"Aktakuza ndaj Fatmir Shehollit: Prokuroria pretendon ndërhyrje në zgjedhje dhe plan për ta paraqitur Kosovën si 'Kandahar'"
Trupi i artikullit	Trupi e quan "dokument për radikalizimin e Kosovës"; përdor "qendra tregtare", "Kosova do të duket si Kandahar" dhe "shtet i radikalizuar dhe ekstremist", por ia atribuon këto interpretimit të Prokurorisë.
Artefakti thotë	Termet "radikalizim", "ekstremist" dhe "qendra tregtare" nuk janë në artefakt. Formulimi burimor kufizohet te një pjesë e Kosmetit dhe përdor "qendra qytetesh".

Data / mediumi	25.08.2026 · ora e parikuperuar: Telegrafi - artikulli i veçantë
Ndryshimi i verifikueshëm	Interpretimi identifikohet si i Prokurorisë, çka e bën trupin më të mbrojtur. Titulli dhe nëntitulli, megjithatë, e bëjnë termin "radikalizim" emër të vetë dokumentit.
Teknika e evidentuar	Etiketim interpretues; normalizim; përkthim i pasaktë; shtrirje e zgjeruar.
Referenca	[R092]

Data / mediumi	25.08.2026 · 19:33 CEST: Dukagjini
Titulli	"Dokumenti 'Top Secret 2' në telefonin e Shehollit: Plani që synonte ta paraqiste Kosovën si shtet të radikalizuar"
Trupi i artikullit	Trupi përdor "sipas vlerësimit të Prokurorisë", "zgjerimin e ndikimit të radikalizimit islamik" dhe "shtet i radikalizuar dhe ekstremist". Në fund sqarohet se pretendimet nuk janë fakte të vërtetuara me aktgjykim.
Artefakti thotë	Artefakti nuk përdor këto etiketa. Ai jep pretendime për përhapjen e Islamit, ndikimin te figura publike, largimin e të rinjve dhe ndryshimin e perceptimit perëndimor.
Ndryshimi i verifikueshëm	Titulli e vendos interpretimin si "plan"; trupi e rikthen atribuimin te Prokuroria dhe shton rezervën juridike.
Teknika e evidentuar	Interpretim në titull; atribuim dhe rezervë në trup; transferim i statusit nga aktakuza te fotografia.
Referenca	[R087]

Data / mediumi	25.08.2026 · 18:02 CEST: Pamfleti
Titulli	"Nga radikalizimi islamik te komprometimi i Kurtit, si BIA serbe tentoi të destabilizonte Kosovën"
Trupi i artikullit	Artikulli bashkon "Top Secret 2", dokumenti "Leptiri", akuzat për rekrutim të Kurtit, komunikime dhe prova të tjera të aktakuzës nën një histori të vetme të BIA-s.
Artefakti thotë	"Top Secret 2" nuk përmend Albin Kurtin, "Leptirin", radikalizim, ekstremizëm ose BIA si autor. "Leptiri" është objekt tjetër me zinxhir tjetër në aktakuzë.
Ndryshimi i verifikueshëm	Dy objekte të ndryshme te evidences bashkohen në një titull; autoriteti dhe aktori i dokumentit tjetër projektohen mbi fotografinë.
Teknika e evidentuar	Bashkim i narrativave; fajësim nga afërsia; atribuim i autorit; kompresim i dosjes në një skenar të vetëm.
Referenca	[R080]

9.5 Titujt pasues që e zmadhuan pretendimin

Publikimi	Titulli / formulimi	Ndryshimi	Ref.
14:44 · Lajmi.net	Përsërit titullin dhe tekstin e KALLXO-s tetë minuta më vonë.	Kopje e një burimi; jo konfirmim i dytë.	R065
15:18 · Periskopi	"Pas 20 vitesh Kosova do të duket si Kandahari..."	Hiqet "një pjesë"; "pretendohet" nuk është në titull.	R066
17:16 · Top Channel	"Kosova do të duket... zbulohet plani..."	Rikthim i vitit 2018 paketohet si zbulim; "plan" dhe gjithë Kosova.	R073
18:54 · BalkanWeb	"zbulohet plani top sekret i gjetur te Fatmir Sheholli"	Posedimi afrohet semantikisht me origjinën; kornizim, fajesim.	R084
19:35 · FokusNews	"fotografia Top Sekret i shërbimit sekret serb..."	Institucioni lëshues pohohet në titull, ndonëse nuk shihet në fotografi.	R088
20:25 · Top News	"plani serb për shpopullimin e Kosovës"	"Shpopullim" nuk përdoret në artefakt; largimi i një pjese shndërrohet në objektiv kombëtar.	R090

Publikimi	Titulli / formulimi	Ndryshimi	Ref.
26.08 · Lapsi/Nacionale	"BIA's Plan to Return Kosovo to Kandahar"	BIA vendoset si autor i planit pa identifikues institucional të fotografisë.	R113

9.6 Fjalori që nuk gjendet në artefakt

1	radikalizim islamik	Faqja flet për përhapjen e Islamit; termi nuk përdoret.
2	shtet ekstremist	Nuk përdoret.
3	destabilizim	Nuk përdoret si term.
4	zbrasje / shpopullim	Thuhet se një pjesë e rinisë do të largohet.
5	qendra tregtare	Origjinali ka "gradskih centara" – qendra qytetesh.
6	e gjithë Kosova	Origjinali ka "deo Kosmeta" – një pjesë.
7	juridiksioni i Serbisë	Origjinali ka "pod nadzorom" – kontroll/mbikëqyrje.
8	plan i BIA-s	BIA nuk emërtohet si lëshues në faqe.
9	CIA / Qeveria Haradinaj	Nuk emërtohen; hyjnë më 2023.
10	duhet ta bëjmë si Kandaharin	Origjinali thotë se një pjesë "do të duket" si Kandahar.

Figura 7. Fjalori që hyri nga interpretimi, titulli ose përkthimi i mëvonshëm.

Termi i transmetuar	Çka ka fotografia	Lloji i ndryshimit
"radikalizim islamik"	Nuk përdoret. Fotografia flet për përhapjen e Islamit dhe për zgjedhjen e fesë nga një pjesë e popullsisë.	Interpretim i Prokurorisë / editorial.
"shtet ekstremist"	Nuk përdoret.	Etiketim i mëvonshëm.
"destabilizim"	Nuk përdoret si term.	Përmbledhje e pasojës së pretenduar.
"zbrasje / shpopullim i Kosovës"	Nuk përdoret. Thuhet se një pjesë e rinisë do të largohet dhe më vonë përmendet migrimi drejt Turqisë.	Zgjerim nga pjesa të e gjithë popullsia.
"qendra tregtare"	Origjinali ka "gradskih centara" - qendra të qyteteve.	Perkthim i pasakte.
"Kosova do të duket si Kandahar"	Origjinali ka "deo Kosmeta" - një pjesë e Kosmetit.	Zgjerim i shtrirjes.
"nën juridiksionin e Serbisë"	Origjinali ka "pod nadzorom Srbije" - nën kontroll/mbikëqyrje.	Legalizim i formulimit.

Termi i transmetuar	Çka ka fotografia	Lloji i ndryshimit
"plan i BIA-s"	BIA nuk emërtohet në fotografi.	Atribuim institucional i mëvonshëm.
"CIA / Qeveria Haradinaj"	Nuk emërtohen.	Prejardhje e shtuar më 2023.
"duhet ta bëjmë si Kandaharin"	Origjinali parashikon se një pjesë "do të duket" si Kandahar.	Parashikim → urdhër.

9.7 Kur gjuha “përmirësohet”, humbet një pjesë e provës

Artefakti me tekst serbisht është i çrregullt. Përkthimet e rrjedhshme e bëjnë skenarin më koherent dhe më institucional sesa kopja që lexon publiku. Kjo nuk është problem vetëm stilistik: normalizimi mund të fshehë gjurmët që e dobësojnë hipotezën e një dokument final zyrtar.

Artefakti	Forma e transmetuar	Efekti
“amabsada”	“ambasadat”	Gabimi zhduket; lexuesi shqip nuk sheh gjurmët dalluese.
“džamije treba da se dvostruke i trostruke”	“numri i xhamive duhet të dyfishohet dhe trefishohet”	Riparohet gramatika dhe ndryshohet subjekti i fjalisë.
“deca i mladih”	“fëmijë dhe të rinj” / KALLXO: “fëmijë dhe të rritur”	Rregullohet rasa; një degë ndryshon edhe grupmoshën.
“na sto vidljiva mesta”	“në vende sa më të dukshme”	Ndërtimi jo standard bëhet udhëzim i pastër.
“gradskih centara”	“qendra tregtare”	Nuk është vetëm pastrim gjuhësor; kuptimi ndryshon.
“deo Kosmeta izgleda ce kao Kandahar”	“Kosova do të duket si Kandahar”	Hiqet “një pjesë”, rregullohet koha dhe zmadhohet pretendimi.
“pod nadzorom Srbije”	“nën juridiksionin e Serbisë”	Kontrolli/mbikëqyrja kthehet në term juridik.
“naši ljudi”	“njerëzit tanë - të UDB-së dhe BIA-s”	Institucioni shtohet brenda përkthimit.

PËRFUNDIMI I KËTJ KAPITULLI

Transmetimi nuk e ndryshoi vetëm statusin e fotografisë. Në disa raste ndryshoi fjalët, shtrirjen, autorin e pretenduar, forcën gramatikore dhe vetë objektin e frikës.

10. Si u rrit autoriteti pa shtuar prejardhjen




Figura 8. Rritja e autoritetit të bartësit: çdo hap shton peshë sociale ose institucionale, jo identifikues të rinj te fotografise.

Ky proces mund të ndahet në dy forma. Pastrimi horizontal ndodh kur portale të shumta kopjojnë të njëjtën degë dhe përsëritja krijon përshtypjen e disa konfirmimeve. Pastrimi vertikal ndodh kur i njëjti

objekt kalon te një bartës me autoritet më të madh: portal, ish-zyrtar anonim, ish-kryeparlamentar, CIA e pretenduar, televizion dhe në fund dosje penale.

Në secilin hap, lexuesi mund të humbë nga sytë pyetjen fillestare: **kush e shkroi dokumentin dhe si jemi të sigurt për autenticitetin e tij?** Ky është mekanizmi më i dokumentueshëm i raportit. Koordinimi qendror, pagesat ose tasking-u nuk janë provuar. Për t'i provuar do të duheshin komunikime, administratorë të përbashkët, drafte para publikimit, pagesa ose urdhra.

PËRZGJEDHJA

E njëjta fotografi u përdor për të nxjerrë mesazhe të ndryshme në valë të ndryshme. Herë në qendër u vendos Turqia, herë xhamitë dhe "islamizimi", herë Kandahari dhe radikalizimi, herë emigrimi, ndërsa në fazat e mëvonshme u theksuan CIA-ja ose BIA-ja si burime të pretenduara autoriteti. Vetë objekti përmbante mjaft tema, aktorë dhe simbole që secila valë të mund të zgjidhte pjesën që i përshtatej më së miri kontekstit të momentit.

11. Çka ishte temë kur fotografia rikthehej

Fotografia përmban mjaft tema që mund të lidhen me debate të ndryshme: Turqinë, Serbinë, xhamitë, diasporën, emigrimin, Përfundimin dhe "Kandaharin". Prandaj analiza kontrollon çfarë pjese u nxor në titull, çfarë teme ishte aktive në atë periudhë dhe çfarë u la jashtë.

- Përputhje direkte: i njëjti aktor dhe e njëjta çështje brenda 14 ditëve.
- Përputhje e fortë tematike: së paku dy zhvillime të lidhura brenda 30 ditëve.
- Kontekst receptiv: tema ishte e pranishme, por lidhja mbetet e përgjithshme.

 VALA	 LAJMI I FRESKËT	 FRAGMENTI I AKTIVIZUAR
 GUSHT 2018	Turqia + Serbia	"drita e gjelbër" / islamizimi / dëbimi
 GUSHT 2020	Xhamia Qendrore + financimi turk	xhami "në vende të dukshme"
 SHTATOR 2021	Talebanët + afganët në Kosovë	Kandahari
 GUSHT 2022	Barrikadat + Afganistani	Serbia ose Kandahari, sipas titullit
 MARS 2023	Criri + NATO + Ramazani	CIA / Qeveria Haradinaj
 KORRIK 2024	Akuza për xhami konkrete	financimi i xhamive
 GUSHT 2026	BIA + ISIS + konflikt fetar	radikalizim / ekstremizëm / BIA

 Ky vizual përshkruan zgjedhjen editoriale. Kontrolli negativ tregon se tema të ngjashme dalin edhe pa rikthim të fotografisë; prandaj nuk përdoret si provë komandimi.

Këto kategori matin vetëm afërsinë me kontekstin e momentit, jo qëllimin, koordinimin ose shkakësinë. [R133-R176]

11.1 1-2 gusht 2018: Turqia dhe Serbia ishin tashmë në të njëjtën fjalë

Gjurma më e hershme mediale e rikuperuar përdori "TURQIA I JEP DRITEN E GJELBERT SERBISE". Më 2 gusht, degët pasuese ngritën "islamizimin", dëbimin në Turqi dhe Kandaharin.

Lajmet aktive në dritare

- 29 korrik: Gjergj Dedaj i quajti Turqinë dhe Serbinë "shtrigat e Ballkanit" dhe foli për rikthim strategjik përmes emisarëve. Qeveria u distancua dhe partnerët e koalicionit kërkuan shkarkimin. [R133]
- 1-2 gusht: dialogu me Serbinë, "korrigjimi" ose ndarja e kufirit, Asociacioni, NATO dhe rreziku i incidenteve në veri ishin në ballina. [R134, R172]
- 3 gusht: djegia e flamurit turk dhe reagimi institucional e mbajtën marrëdhënien me Turqinë në ciklin e lajmit. [R135]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Titulli e lidhi fotografinë me dy shtetet që publiku po i dëgjonte tashmë në të njëjtën polemikë. Pjesa për "dritën e gjelbër" u bë grepi i valës; pjesët për diasporën dhe figurat publike nuk dolën në titull.

Kategoria: Përputhje direkte. Kjo shpjegon lexueshmërinë editoriale; nuk dokumenton kush e krijoi fotografine ose nëse publikimi u sinkronizua.

11.2 22 shtator 2018: nga kufiri te pyetja "cila është feja e shqiptarëve?"

Një llogari individuale e publikoi fotografinë me tri pamje xhamish dhe pyetjen "Cila është feja e Shqiptarëve?". Nuk u gjet valë mediale po atë ditë.

Lajmet aktive në dritare

- Javët paraprake ishin të mbushura me korrigjimin ose shkëmbimin e kufirit, Preshevën, veriun dhe frikën nga ndarja mbi baza etnike.
- 21 shtator: Hashim Thaçi deklaronte mbështetje të gjerë në kabinet për korrigjimin; opozita kërkonte refuzim të kufijve etnikë. [R136]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Ankthi "kush është Kosova dhe ku mbaron?" u zhvendos nga territori te përkatësia fetare. Fotografia e xhamive e bëri lidhjen vizuale; artefakti nuk identifikon ato objekte.

Kategoria: Kontekst receptiv. Nuk u gjet lajm po aq direkt për ndërtimin ose financimin e xhamive në ditët e afërta.

11.3 1-5 nëntor 2018: vizita turke, BIK-u dhe rikthimi territorial

Bota Sot e riktheu objektin me titullin për rikthimin e Kosovës nga Serbia dhe "dritën jeshile" të Turqisë. Në hyrje u shfaq "ish-zyrtari i lartë"; historia e gushtit nuk u shpjegua.

Lajmet aktive në dritare

- 19-20 tetor: Mevlüt Çavuşoğlu vizitoi Kosovën, takoi drejtues shtetërorë dhe myftiun Naim Tërnavë, diskutoi FETO-n dhe vizitoi xhami e objekte osmane. [R137]
- 31 tetor: Parlamenti diskutonte propozimet për korrigjimin e kufirit. [R173]
- Fillimi i nëntorit: dialogu Kosovë-Serbi, ushtria, Interpoli dhe sovraniteti dominonin. Më 6 nëntor u vendos tarifa 10 për qind ndaj mallrave serbe e boshnjake. [R138]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Titulli bashkoi Turqinë si aktor shtetëror, xhamitë/BIK-un dhe Serbinë si kërcënim territorial. Burimi i ri anonim e bëri objektin të dukej si zbulim, jo riciklim.

Kategoria: Përputhje direkte. Vizita e freskët shpjegon grepin editorial; nuk vërteton "dritën e gjelbër".

11.4 7-9 dhjetor 2018: Interpoli, tarifa 100%, ushtria dhe NATO

Më 7 dhjetor, materiali u quajt "tejet i besueshëm" nga një autoritet politik dhe u lidh me një shërbim të huaj me ndikim botëror. Emri i shërbimit dhe metoda nuk u publikuan.

Lajmet aktive në dritare

- 20 nëntor: Kosova dështoi të anëtarësohej në Interpol pas fushatës së Serbisë. [R139]
- 21 nëntor: tarifa ndaj mallrave serbe e boshnjake u ngrit në 100 për qind.
- 5 dhjetor: Jens Stoltenberg kritikoi tarifat dhe transformimin e FSK-së. [R140]
- 7 dhjetor: ushtria, mbështetja amerikane, kundërshtimi i Serbisë dhe paralajmërimet e NATO-s dominonin përmbledhjet e ditës. [R141]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Fotografia u bë shpjegim i përgjithshëm: Serbia nuk po vepronte vetëm diplomatikisht dhe ekonomikisht, por edhe "përmes fesë". Autoriteti i burimit të deklaruar u rrit në moment të pasigurisë së lartë.

Kategoria: Përputhje direkte. Afërsia me krizën nuk zëvendëson shërbimin, dokumenti shoqërues ose autentikimin.

11.5 2 qershor 2020: kundërkornizim në një ditë të dominuar nga politika dhe pandemia

Bosnjaci.net e trajtoi fotografinë si falsifikim dhe si pjesë të një diskursi anti-mysliman.

Lajmet aktive në dritare

- 2 qershor: votimi i Qeverisë Hoti, legjitimiteti kushtetues, reciprociteti me Serbinë, pandemia dhe viktimat në Artanë dominonin agjendën. [R142]
- Në javën paraprake, BIK-u kishte anuluar faljen dhe pritjen e Fitër Bajramit për shkak të pandemisë. [R143]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Këtu fotografia nuk u përdor për ta shtyrë narrativën e vet; u përdor për ta kundërshtuar atë. Tema fetare ishte aktive, por jo lajmi kryesor i ditës.

Kategoria: Kontekst receptiv. Dalja i përgjigjet një klime të grumbulluar, jo një shkaktari të vetëm.

11.6 8-11 gusht 2020: xhami e dukshme, financim turk dhe protestë

Titujt ngritën fjalë për fjalë "sa më shumë xhami në vende të dukshme", "mercenarët shqiptarë" dhe largimin e rinisë.

Lajmet aktive në dritare

- 15 korrik: rifilluan punimet për Xhaminë Qendrore të Prishtinës, të financuar nga Turqia.
- 21-22 korrik: pati protestë dhe kundërprotestë për madhësinë, dukshmërinë, financimin dhe pretendimin se Kosova po trajtohej si "provincë e Turqisë". [R144]
- Reagimi i Hashim Thaçit mbështeti projektin dhe kundërshtoi nxitjen e urrejtjes fetare. [R145]
- Fundi i korrikut: paqartësitë dhe kufizimet për faljen e Kurban Bajramit krijuan konflikt të dytë publik rreth xhamive. [R146]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Dy-tri javë pas një debati kombëtar për një xhami të madhe dhe financim turk, u zgjodh pikërisht paragrafi për xhamitë në vende të dukshme. Fragmenti dukej sikur po komentonte lajmin e ditës.

Kategoria: Përputhje direkte. Lokacioni dhe financimi i një projekti real nuk autentikojnë planin anonim.

11.7 11 shtator 2021: “Kandahari” kur Afganistani ishte fizikisht në Kosovë

Koha Jonë riktheu degën e Bota Sot-it pa provë të re për prejardhjen.

Lajmet aktive në dritare

- 29 gusht: mbërriti grupi i parë prej 111 afganësh; Kosova kishte pranuar strehim të përkohshëm për deri në 2,000 persona. [R147]
- 6 shtator: qindra afganë ndodheshin pranë Bondsteelit dhe në bazën amerikane. [R148]
- 11 shtator: Kosova shënoi 20-vjetorin e sulmeve në SHBA, ndërsa talebanët konsolidonin pushtetin. [R149]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Fjala “Kandahar” mbante një ngarkesë që nuk e kishte në një muaj normal: talebanë, evakuim, Bondsteel dhe 11 Shtator. Metafora u bë aktuale pa asnjë autentikim të ri.

Kategoria: Përputhje direkte. Data e publikimit e rrit efektin e titullit; nuk dëshmon planifikim të datës.

11.8 8-20 gusht 2022: dy kriza, dy fragmente

Katër publikime alternuan “Kosovën ta bëjmë si Kandaharin” dhe “sa më shumë xhami në vende të dukshme”.

Lajmet aktive në dritare

- Fundi i korrikut dhe fillimi i gushtit: barrikada, targa dhe dokumente në veri.
- 18 gusht: Albin Kurti dhe Aleksandar Vučić u takuan në Bruksel; KFOR-i deklaronte gatishmëri.

[R150] • 15 gusht: përvjetori i parë i marrjes së Afganistanit nga talebanët. • 17 gusht: Qeveria premtoi vazhdimin e mbështetjes për afganët në Bondsteel. [R151]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Një degë zgjodhi Serbinë dhe destabilizimin territorial; tjetra Kandaharin dhe Afganistanin. E njëjta fotografi funksionoi si depo me disa grepa editorialë.

Kategoria: Përputhje direkte. Ndryshimi mes titujve tregon modularitetin e objektit, jo një burim të ri.

11.9 24-26 mars 2023: CIA, Qeveria Haradinaj, NATO dhe Ramazani

Më 24 mars, një postim shtoi se Qeveria Haradinaj e kishte siguruar materialin nga CIA amerikane. Dokument deklasifikimi, procesverbal ose regjistër qeveritar nuk u publikua.

Lajmet aktive në dritare

- 18 mars: në Ohër u arrit aneksi i zbatimit të marrëveshjes Kosovë-Serbi. [R152]
- 23 mars: filloi Ramazani. [R153]
- 24 mars: shënohej përvjetori i ndërhyrjes së NATO-s; në Serbi data kornizohej si “agresion”.

[R154]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Brenda së njëjtës dritare u bashkuan CIA/NATO, Serbia, marrëveshja e Ohrit dhe Islami. Pretendimi i ri për prejardhjen i dha fotografisë një burim amerikan pikërisht kur autoriteti perëndimor ishte në qendër të kujtesës publike.

Kategoria: Përputhje e fortë tematike. Nuk u gjet lajm i drejtpërdrejtë që prodhoi pretendimin CIA/Qeveria Haradinaj.

11.10 27 qershor-9 korrik 2024: fotografia hyn në konfliktin për xhami konkrete

Më 27 qershor u publikua akuza se dy xhami në Prishtinë ishin financuar nga Serbia; më 9 korrik fotografia u shfaq në televizion si plan i shërbimit informativ serb.

Lajmet aktive në dritare

- 2 korrik: myftiu Naim Tërnavë kërkoj prova dhe paralajmëroi padi për pretendimet rreth xhamive në Mat dhe Veternik. [R155]
- 9 korrik: Gëzim Kelmendi dhe imami Fadil Musliu i kundërshtuan akuzat; në debat u tha se pretendimet e paverifikuara mund të prodhonin pikërisht përçarjen që i atribuohet Serbisë. [R156]

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Objekti nuk iu bashkua vetëm një teme që ishte aktuale. U përdor si rekuizitë brenda saj. Pyetja publike kaloi nga “a është autentik?” te “kush e financoi këtë xhami?”.

Kategoria: Përputhje direkte. Një fotografi anonime nuk mund ta mbyllë zinxhirin e provës për një objekt të veçantë.

11.11 5 gusht 2025: pse nyjës private nuk i montohet një agjendë publike

Sipas aktakuzës, një kopje iu dërgua kontaktit “Viktor Makedonija”. Kjo nuk ishte dalje publike.

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Pa tekstin para dhe pas bashkëngjitjes, kërkesën e marrësit, orën e plotë dhe skedarin origjinal, nuk dihet nëse ishte përgjigje, material i njohur, udhëzim, lajm ose arkiv personal.

Kategoria: Nuk aplikohet klasifikim HOT. Nyja mund të provojë posedim/transmetim; nuk jep kontekst publik të auditueshëm.

11.12 25-26 gusht 2026: pothuajse të gjithë komponentët semantikë ishin aktivë

Aktakuza ishte shkasi procedural. Në 14:36 KALLXO publikoi nyjën e parë dokument-specifike të rikuperuar me minutë; brenda orëve u shfaqen “plani serb”, “radikalizimi”, “zbrazja”, “fondet për xhami” dhe “zbulohet”.

Lajmet aktive në dritare

- 15 qershor: u raportua dënimi i Hysri Selimit për spiunazh; rasti lidhej me BIA-n, ISIS-in, persona të radikalizuar. [R157]
- 8 gusht: lajmi mbi statistikën e 6 mujorit të parë me 11 aksidente hekurudhore, një fatal, dhe mungesë barrierash/sinjalizimi ushqenin kritikën ndaj institucioneve; lidhja me fotografën është e dobët. [R163]
- 17-23 gusht: konflikti për kishën “Shën Flori dhe Lauri” në Zogaj përfshiu Dioqezën, Policinë, Komunën, banorët, BIK-un lokal dhe “Lëvizjen për Rikthim”. [R160-R162]
- 19 gusht: u publikua analizë për interesimin e BIA-s ndaj rrjeteve islamiste dhe personave për kontaktim/rekrutim. [R164]
- 21 gusht: u risoll rrëfimi për armët e UÇK-së të fshehura në xhaminë e Burojës; burimi historik i BIK-ut jep datat dhe vendin e fshehjes. [R158-R159]
- 24 gusht: Prokuroria Speciale dorëzoi aktakuzën.

ÇKA AKTIVIZOI FOTOGRAFIA

Para publikimit, publiku kishte dëgjuar BIA, ISIS, xhami, armë në xhami, konflikt kishtar dhe spiunazh. Aktakuza dha autoritet procedural; fjalori i ditëve paraprake e bëri interpretimin “radikalizim islamik” të duket si tekst i fotografisë, edhe pse nuk është.

Kategoria: Përputhje direkte. Kjo është dritarja ku duhet dalluar më fort artefakti nga interpretimi i Prokurorisë dhe nga titulli medial.

11.13 Kontrolli negativ: sa e veçantë është përputhja?

Serbia, dialogu, NATO, Turqia dhe identiteti fetar janë tema të shpeshta në Kosovë. Nëse kërkimi bëhet mjaftueshëm gjerë, ato gjenden edhe kur fotografia nuk po qarkullon. Për këtë arsye u përdorën tri data kontrolli: e njëjta datë kalendarike një vit pas tri valëve të forta; kur nuk kishte edicion atë ditë, u mor edicioni i parë pasues. [R174-R176]

 Dritarja	 Serbi / territor	 Fe / xhami	 Turqi / Lindje	 NATO / siguri
DALJE 02.08.2018	☒	☐	☒	☒
DALJE 11.09.2021	☒	☐	☐	☒
DALJE 24.03.2023	☒	☒	☐	☒
KONTROLL 02.08.2019	☒	☐	☐	☒
KONTROLL 12.09.2022	☒	☐	☒	☒
KONTROLL 25.03.2024	☒	☒	☐	☒

☒ temë e dukshme në burimin e kontrollit / dritares
 ☐ jo dominante në burimin e përdorur

Figura 10. Tri valë reale dhe tri data kontrolli. Mbivendosja tematike shfaqet edhe pa rikthim të objektit.

Data e kontrollit	Rregulli	Çka doli	Leximi
02.08.2019	Një vit pas valës së parë	Dialogu me Serbinë dhe harta/territori ishin sërish në krye.	Temat ekzistojnë pa fotografinë.
12.09.2022	Edicioni i parë pas 11.09	Dialogu, mbështetja e Turqisë, 11 Shtatori dhe KFOR-i në të njëjtin edicion.	Mbivendosje e lartë pa valë.
25.03.2024	Edicioni i parë pas 24.03	NATO, Serbia, rituali kishtar dhe siguria krijojnë afërsi tematike.	Përputhja nuk provon shkakësi.

ÇKA PROVOI KJO PJESË

Ky seksion shpjegoi përzgjedhjen editoriale: cili paragraf u ngrit dhe pse ishte i lexueshëm atë ditë. Nuk provon se datat u planifikuan, se publikuesit morën urdhër ose se përputhja autentikon BIA-n.


12. Audienca, emocioni dhe kohezioni shoqëror

Ky kapitull analizon arkitekturën e rrëfimit, jo mendjen e secilit publikues. “Orkestrimi narrativ” përdoret për mënyrën si sekretësia, armiku, tradhtari i brendshëm, afati 20-vjeçar dhe imazhi “Kandahar” punojnë së bashku. Nuk përdoret si sinonim për qendër komandimi, pagesë ose tasking të përbashkët.

12.1 Kur korniza bëhet anti-myslimane

Kritika ndaj Islamit, një institucioni fetar, financimit të një xhamie ose një rreziku konkret sigurie nuk është automatikisht islamofobi. Raporti përdor termin “kornizë islamofobe” vetëm kur kalimi bëhet nga një veprim ose provë individuale te dyshimi kolektiv: identiteti mysliman, praktika e dukshme, xhamia, medreseja ose figura publike paraqiten si shenjë e pabesisë kombëtare, kontrollit të huaj ose rrezikut të sigurisë pa evidencë për individin. ECRI e përshkruan “othering”-un si proces që nis me përgjithësime të gjera dhe me paraqitjen e Islamit si kërcënim të jashtëm. Ajo paralajmëron se lidhja e vazhdueshme e myslimanëve/Islamit me terrorizmin ose ekstremizmin mund t'i pozicionojë si “tjetri” i huaj dhe të krijojë “komunitet të dyshuar”. Po i njëjti dokument ruan dallimin mes kritikës së arsyeshme dhe urrejtjes ndaj një grupi. [R179]

12.2 Audiencat nuk marrin të njëjtin mesazh



Audienca	Mesazhi i pakeluar
Publiku i gjerë	Rreziku është i fshehtë, afatgjatë dhe ekzistencial.
Publiku kombëtarist	Feja mund të përdoret për zhbërjen e identitetit kombëtar.
Diaspora	Ndarja dhe financimi i huaj veprojnë aty ku ka kapital e ndikim.
Mediat	Një "rrjedhje sekrete" me Turqi, Serbi, xhami, dëbim dhe afat 20-vjeçar.
Elitat politike/institucionale	Material për hetim, përgjegjësi, kritikë ose përplasje politike.

Audienca	Mesazhi i pakeluar
Besimtarët dhe institucionet islame	Vendosen në pozitën e të dyshuarit dhe duhet të dëshmojnë lojalitetin.
Perëndimi i imagjinuar	Gjykatësi që mund ta braktisë Kosovën nëse ajo paraqitet si "Kandahar".
Audienca e sigurisë	Një fotografi pa metadata lexohet pranë BIA-s, ISIS-it dhe dosjes penale.

12.3 Ngarkesa emocionale

Elementi	Emocioni	Efekti narrativ
Humbja e Kosovës	Frikë ekzistenciale	Çdo rezervë shihet si rrezik për mbijetesën.
Turqia i jep leje Serbisë	Tradhti	Aleati kulturor/fetar kthehet në bashkëpunëtor të armikut.
Operativë brenda shqiptarëve	Paranojë	Institucionet dhe figurat publike mund të futen në të njëjtin rrjet dyshimi.
Fëmijët dhe medresetë	Panik moral	Kërcënimi paraqitet si projekt brez pas brezi.
Xhamitë në vende të dukshme	"Pushtim" simbolik	Arkitektura fetare lexohet si kontroll territori.
Kandahar	Poshtërim / stigmë	Një imazh i vetëm zëvendëson argumentin kompleks.
Perëndimi largohet	Braktisje	Mund të krijojë ndjesinë se koha po mbaron.
Dëbimi në Turqi	Traumë historike	Aktivizohet kujtesa e shpërnguljeve.
20 vjet	Numrim mbrapsht	Teksti merr pamje strategjike dhe urgjencë.

12.4 Si ndërtohet narracioni

1. Fotografia merr autoritet nga etiketa "Top Secret", jo nga identifikuesit.
2. Kërcënimi paraqitet si i fshehtë dhe afatgjatë; mungesa e provës kthehet në pjesë të sekretësisë.
3. Veprimi i jashtëm kërkon bashkëpunëtor të brendshëm: imam, politikan, sportist, artist, media, diasporë.
4. Praktika e dukshme fetare kthehet në gjurmë sigurie. Xhamia nuk është më vetëm objekt kulti; bëhet territor dhe provë infiltrimi.
5. "Kandahari" i jep narrativës një imazh të gatshëm të prapambetjes, ekstremizmit dhe humbjes së Perëndimit.
6. Titulli i mëvonshëm shton fjalorin e sigurisë: radikalizim, ekstremizëm, BIA, ISIS dhe e bën këtë fjalor të duket sikur ishte në fotografin e vitit 2018.
7. Përsëritja nga shumë media zëvendëson pyetjen "nga erdhi?" me përshtypjen "të gjithë po e konfirmojnë".

NARRATIVA

Më shumë Islam → më pak shqiptari → më shumë fuqi për Serbinë. Ky është ekuacioni që transmetimi i vesh fotografisë. Ai nuk del si formulë e provuar nga metadata, aktorë të emërtuar ose zinxhir operativ.

12.5 Nga rreziku konkret te "komuniteti i dyshuar"

Fotografia bën një lëvizje të gjerë: nga pretendimi për disa operativë kalon te udhëheqsit e bashkësive islame në disa shtete, te sporti, muzika, mediat, partitë, romët, diaspora dhe rinia. Kategoritë janë aq të gjera sa një shenjë e zakonshme fetare mund të lexohet si konfirmim. Kjo është pikërisht forma ku rreziku konkret humb individualizimin dhe kthehet në dyshim mbi grupin.

Në Valën e Fundit, afërsia me BIA-n, ISIS-in dhe dosjen penale e përshpejton këtë kalim. Fotografia nuk përmban "radikalizim islamik" ose "shtet ekstremist", por këto etiketa hyjnë në titull dhe trup. Kështu publiku nuk merr vetëm një përkthim; merr një udhëzim se si duhet lexuar identiteti mysliman në fotografi.



Figura 12. Rrugët e mundshme nga korniza e transmetuar te dyshimi horizontal dhe dobësimi i besimit shoqëror.

12.6 Çka rrezikon kohezioni shoqëror

Rreziku kryesor është horizontal. Konflikti Kosovë-Serbi zhvendoset brenda komunitetit: shqiptar "kombëtar" kundër shqiptarit mysliman; institucion "i pastër" kundër institucionit që duhet ta provojë lojalitetin; objekt fetar kundër hapësirës kombëtare. Kjo nuk ka nevojë që publiku ta besojë çdo fjali. Mjafton që dyshimi të bëhet korniza e zakonshme e debatit.

ECRI paralajmëron se paralelet e pasakta mes terroristëve/ekstremistëve dhe myslimanëve si tërësi prodhojnë refuzim, armiqësi, alienim dhe perceptimin e një "komuniteti të dyshuar". Ajo lidh këtë me humbjen e besimit, përkeqësimin e ndarjeve shoqërore dhe efektet mbi pjesëmarrjen publike.

UNESCO e trajton gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin si kërcënim për të drejtat, sigurinë dhe kohezionin shoqëror. [R179-R180]

Në këtë rast, raporti nuk mat sa persona ndryshuan qëndrim. Nuk ka pyetësor për dokumentin, shtrirje historike të plotë ose seri komentesh të krahasueshme. Ai dokumenton mekanizmin e paraqitur publikut: si përkatësia fetare bëhet indikator kombëtar dhe sigurie, dhe si ky mekanizëm forcohet me çdo bartës të ri.

12.7 Gjuha ndryshoi edhe audiencën

Gjuha / paketa	Çka bartet	Çka duhet mbajtur mend
Shqip - vala 2018	Tradhti serbo-turke, spastrim, "kombi para fesë", Kandahar.	Shtesat e përkthimit hyjnë pranë tekstit burimor.
Shqip - 2024	Financim i xhamive konkrete.	Pretendimi abstrakt aplikohet te objekte dhe institucione reale.
Shqip - 2026	Radikalizim, ekstremizëm, destabilizim, zbrazje.	Fjalori procedural/editorial nuk është tekst i artefaktit.
Anglisht	Rast spiunazhi / mbështetje perëndimore / plan i BIA-s	Paketa kalon nga debat vendor në kornizë ndërkombëtare.

Gjuha / paketa	Çka bartet	Çka duhet mbajtur mend
Turqisht, greqisht, maqedonisht, gjermanisht	Pasqyra të të njëjtit publikim të KOHA-s.	Gjashtë gjuhë janë një burim editorial, jo gjashtë konfirmime.

12.8 Çka mund të thuhet dhe çka jo

E MBËSHTETUR

Fotografia dhe paketimet e saj ofrojnë një kornizë që lidh Islamin me humbjen e shqiptarisë, territorit dhe mbështetjes perëndimore; valët e mëvonshme i shtojnë fjalor sigurie që nuk gjendet në artefakt.

E PAMBËSHTETUR

Nuk është matur efekti real mbi opinionin, nuk është provuar një qendër e vetme komandimi dhe nuk mund t'u atribuohet motiv publikuesve vetëm nga fakti se e kanë shpërndarë ose besuar materialin.

13. Pse duket “profetik”

Përputhja e mëvonshme me ngjarjet nuk është e njëjtë me provën se autori i njihte ato paraprakisht. Këtu testohen njëra pas tjetrës xhamitë pranë rrugëve, infrastruktura fetare pas luftës, medresetë, figurat publike, demografia, emigrimi dhe mënyra si vetë përkthimet e zgjeruan parashikimin.



Figura 13. Mekanizmi i retrodiction-it: një trend i dukshëm kthehet në formulim të gjerë dhe rastet e reja lexohen mbrapsht si përmbushje

PYETJA

Si është e mundur që një dokument pa datë, pa autor, pa institucion lëshues dhe pa zinxhir i posedimit të krijojë përshtypjen se e ka parë Kosovën njëzet vjet përpara?

13.1 Xhamitë pranë autostradave: çka mund të vërtetohet?

Përshtypja e profecisë nis lehtë: dikush sheh një minare pranë autostradës dhe kujton fjalinë e fotografisë. Por në vitin 1993 raportoheshin 607 xhami në Kosovë, shumë para autostradave moderne; së paku 225 u dëmtuan ose u shkatërruan gjatë viteve 1998-1999. R7 u përfundua më 2013 dhe R6 u përfundua më 2019. Shpesh rruga është më e re se vendbanimi dhe objekti fetar. [R119-R122]

Kur një xhami gjendet pranë autostradës, mbeten së paku katër shpjegime: xhamia u ndërtua pranë rrugës; rruga u ndërtua pranë një vendbanimi me xhami; të dyja ndjekin dendësinë e popullsisë; ose objekti u vendos në tokë më të lirë pranë hyrje-daljes së qytetit. Vetëm skenari i parë i afrohet pretendimit. Edhe ai provon lokacionin, jo financuesin ose operacionin.

13.2 Pse xhamitë historike janë pranë qendrës dhe rrugës

Në qytetin osman, xhamia, tregu, hamami, ura dhe rruga kryesore shpesh formonin të njëjtën bërthamë urbane. Xhamia e Hadumit ndodhet në zemër të Çarshisë së Vjetër të Gjakovës; Sinan Pasha dominon qendrën e Prizrenit. Dukshmëria dhe qasja nuk janë shpikje e autostradës dhe nuk kanë vetëm një shpjegim politik. [R128-R129]

I njëjti parim urban funksionon edhe në vende jomyslimane: objektet e komunitetit kërkojnë qasje, transport dhe afërsi me popullsinë. Drejtimi shkakor mund të jetë edhe i kundërt - tregtia dhe trafiku rriten rreth një objekti të vjetër. Pa kronologji parcelë më parcelë, pamja nga makina nuk e zgjidh shkakun.

13.3 Bumi pasluftës: fakt real, shkaqe të shumta

Zgjerimi i infrastrukturës fetare pasluftës është real. Deri në fund të vitit 2010, sipas të dhënave të raportuara nga BIK-u, 113 xhami ishin riparuar ose rindërtuar, 155 ishin të reja dhe 20 ishin në ndërtim; raportimi ngrinte edhe problemin e lejeve. Këto shifra duhen lexuar përballë shkatërrimit të luftës, lirisë së re fetare, kapitalit të diasporës, donatorëve të huaj dhe planifikimit të dobët urban. [R119, R123]

Financimi nga vende dhe organizata myslimane është i dokumentueshëm; ndikimi kulturor ose soft power mund të studiohet rast pas rasti. Një studim i vitit 2026 mbi dy xhami të financuara nga Gjiri në Prishtinë gjeti efekte komunitare, por jo retorikë ose lidhje ekstremiste në ato dy raste. [R132]

13.4 Medresetë dhe “mungesa e interesit”

Zgjerimi institucional i arsimit fetar mund të vëzhgohet: burimet publike listojnë medrese dhe institute në disa qytete. Por formula se ato u shtrinë “kudo ku nuk kishte interes” nuk jep qytete, prag kërkesë, numër nxënësish, financues ose vendimmarrës. Pa këto, pretendimi nuk mund të dështojë dhe prandaj nuk mund të testohet. [R131]

13.5 Vendet informale të faljes dhe radikalizimi

Vendet informale të faljes, kthimet nga zonat e ISIS-it dhe përpjekjet për rekrutim janë çështje reale sigurie. Raportimi i BIRN-it tregon shqetësimin institucional për hapësira jashtë mbikëqyrjes. Kjo e bën të arsyeshme të hetohet monitorimi, infiltrimi ose shfrytëzimi i një fenomeni ekzistues. Nuk provon krijimin e fenomenit nga i njëjti aktor. [R130]

NDARJA QË DUHET RUAJTUR

Krijimi ≠ infiltrimi ≠ monitorimi ≠ përdorimi propagandistik.

13.6 Artistët dhe sportistët: pretendim pa rrezik dështimi

Dokumenti nuk jep emra, kontakte, pagesa, udhëzime, data rekrutimi ose veprime të porositura. Pa zinxhirin aktor → kontaktues → udhëzim → përfitim → veprim publik, çdo sportist që lutet ose çdo artist që përmend besimin mund të numërohet si “provë”. Kjo e bën pretendimin **elastik**, jo parashikim dallues.

13.7 Rritja globale e Islamit: demografi, jo provë e planit

Pew vlerëson se popullsia myslimane u rrit me 347 milionë nga 2010 në 2020, nga 23.9% në 25.6% të popullsisë botërore. Shpjegimi kryesor është demografik: fertilitet mesatar më i lartë dhe moshë mediane më e ulët; kalimet fetare kanë efekt të vogël neto. Një trend global nuk identifikon një operacion lokal. [R124]

13.8 Kosova: përqindje, dukshmëri dhe praktikë

Regjistrimet tregojnë rreth 95.6% vetëdeklarim mysliman në 2011 dhe 93.49% në 2024. Krahësimi kërkon kujdes për mbulimin, bojkotin dhe mënyrën e vetëdeklarimit. Edhe nëse praktika ose dukshmëria fetare rritet brenda një pjese të popullsisë, ajo është tjetër matje nga përqindja numerike dhe nuk e përcakton shkakun. [R125-R126]

13.9 Emigrimi: fenomen real, lidhje shkakore e paprovuar

ASK vlerësoi 37,451 emigrime gjatë vitit 2024 dhe bilanc neto migrimi -28,413. Largimi është i dukshëm. Por për ta lidhur me zinxhirin "islamizim → tjetërsim → emigrim" duhen anketa ose të dhëna individuale që e dallojnë fenë nga punësimi, pagat, bashkimi familjar, arsimit dhe rrjetet e migrimit. [R127]

13.10 Kontradikta historike

Materiali pretendon një strategji serbe për ta mbushur hapësirën publike me xhami. Ndërkohë, evidenca e paraqitur në ICTY dokumenton se mbi një e treta e xhamive ekzistuese më 1993 u dëmtuan ose u shkatërruan gjatë viteve 1998-1999, në shumë raste me shenja sulmi të drejtpërdrejtë. Dy sjellje të kundërta mund të ndodhin në periudha ose struktura të ndryshme; por pretendimi për strategjinë e dytë kërkon prova konkrete dhe nuk del nga vet dokumenti. [R119]

Modeli më i thjeshtë pasluftës: rindërtim pas shkatërrimit, liri fetare, diasporë, donatorë të huaj dhe urbanizëm i dobët shpjegon një pjesë të madhe të rritjes pa kërkuar një plan të vetëm sekret. Kjo nuk përjashton ndikimin e huaj, infiltrimin ose shfrytëzimin në raste të veçanta; vetëm ua cakton barrën e duhur të provës.

13.11 Retrospektivë: pse ora e profecisë nuk ka pikenisje

Dokumenti mbledh dukuri që kishin nisur ose ishin të parashikueshme rindërtimin fetar, donatorët e huaj, emigrimin, rritjen globale të Islamit, figurat publike myslimane dhe narrativën serbe për Kosovën si rrezik islamik dhe i kthen në një plan të vetëm. Më pas, çdo shembull i ri lexohet mbrapsht si përmbushje.

Materiali nuk jep datë krijimi, pikënisje për afatin "20 vjet", numra të pritshëm, lista lokacionesh, emra operativësh, buxhet, përgjegjës, indikator dështimi ose përkufizim operacional të "Kandaharit". Pa to, ora e parashikimit nuk mund të nisë dhe rezultati nuk mund të matet.

13.12 Hipotezat që duhet të mbeten të hapura

Hipoteza	Si përputhet me provat	Prova dalluese
Dokument institucional autentik, por kopje e degraduar	Mundësia nuk përjashtohet; mungesa e lëshuesit, datës, protokollit dhe anomalitë formale e dobësojnë.	Skedar i hershëm me zinxhir institucional.
Bërthamë autentike, e përkthyer ose redaktuar	Mund të shpjegojë disa variante dhe gabime.	Version më i hershëm dhe gjurmë që e lidh me institucionin.
Pamflet anonim mbi trende tashmë të dukshme	Shpjegon mirë pamjen profetike pa njohuri të fshehtë.	Do të dobësohej nga origjinali institucional i datuar.
Objekt publik i riinterpretuar në mënyrë të pavarur	Përputhet me degët që shtojnë burime dhe tituj të ndryshëm.	Koordinimi kërkon komunikime ose drafte të përbashkëta.
Pastrim informacioni	Burimi humbet, ndërsa autoriteti i bartësit rritet.	Do të ndryshonte me zinxhir të plotë, të pandërprerë.
Operacion i koordinuar informativ	Teorikisht i mundshëm, por ngjashmëria e titujve nuk mjafton.	Tasking, pagesa, llogari seed-uese, administratorë ose komunikim.

13.13 Kush përfiton, pa e barazuar përfitimin me autorësinë

Kategoria	Përfitimi potencial	Pse nuk provon autorësinë
Serbia ose aktor armiqësor	Përçarje fe-komb, tension Kosovë-Turqi, dëmtim i imazhit perëndimor.	Një material mund t'i shërbejë Serbisë edhe nëse e krijoi dikush tjetër.
Aktivizëm anti-islam / nacionalizëm sekular	"Provë sekrete" se Islami është instrument kundër shqiptarisë.	Përfitimi ideologjik shpjegon përdorimin, jo skedarin e parë.
Aktorë anti-turkë	Turqia paraqitet si bashkëpunëtore e Serbisë.	Mund ta përdorin pa e prodhuar.
Portale	Klikime, ekskluzivitet, debat dhe engagement.	Nxitja ekonomike nuk identifikon origjinën.
Figura politike	Material për kritikë ndaj institucioneve ose rivalëve.	Mund ta besojnë singlerisht ose ta përdorin politikisht.

Kategoria	Përfitimi potencial	Pse nuk provon autorësinë
Institucione / aktivizëm fetar	Kundërnarrativë ndaj islamofobisë.	Edhe kundërshtari mund të përfitojë pa qenë autor.
Prokuroria / mediat 2026	Objekti ndihmon në ndërtimin e kontekstit të komunikimeve.	Relevanca penale nuk provon autorësinë e vitit 2018.
Krijuesi anonim	Provokim, reputacion, eksperiment, kaos ose manipulim.	Identiteti dhe motivi mbeten të panjohur.

PSE DUKET "PROFETIK"

Sepse kombinon trende të dukshme me **formulime të gjera, pa prag dështimi**, dhe sepse transmetimi i mëvonshëm e zgjeroi "një pjesë" në gjithë Kosovën dhe "do të duket" në "ta bëjmë".

PSE KJO NUK E AUTENTIKON BURIMIN

Përputhja tematike nuk plotëson autorin, datën, skedarin dhe zinxhirin. Mund të jetë parashikim, lexim i trendeve, rastësi, retrodiction ose ripërdorim i mëvonshëm.

14. Hipotezat, testet dhe kufijtë

Hipoteza	Si përputhet me provat	Prova dalluese
Dokument institucional autentik, por kopje e degraduar	Mbetet e mundshme; mungesa e lëshuesit, datës, protokollit dhe anomalitë formale e dobësojnë.	Do ta forconte një skedar i hershëm me zinxhir institucional.
Bërthamë autentike e përkthyer/redaktuar	Mund të shpjegojë disa gabime dhe variante.	Kërkon kopje më të hershme dhe hallkë me institucionin e pretenduar.
Pamflet anonim mbi trende të dukshme	Shpjegon mirë pamjen "profetike" pa kërkuar njohuri të fshehtë.	Do të dobësohej nga origjinal institucional i datuar.
Riinterpretim i pavarur nga aktorë të ndryshëm	Përputhet me degët që shtojnë burime dhe tituj të ndryshëm.	Koordinimi do të kërkonte komunikime ose drafte të përbashkëta.
Pastrim informacioni	Përputhet fort me humbjen e burimit dhe rritjen e autoritetit të bartësit.	Do të ndryshonte po të dilte një zinxhir i plotë i pandërprerë që nga institucioni.
Operacion i koordinuar informativ	Teorikisht i mundshëm, por i paprovuar nga ngjashmëria e titujve.	Kërkon tasking, pagesa, administratorë, orare ose komunikime të sinkronizuara.

14.1 Çka do ta ndryshonte përfundimin

- skedari original ose kopje me metadata para 1 gushtit 2018;
- zinxhir posedimi nga një institucion i identifikueshëm deri te një nga publikuesit e parë;
- loge-t e serverit ose backup/kopjet rezervë CMS që zgjidhin orët e Botapress-it, Selatin Retkocerit dhe UlpianaPress-it;
- skedari i përdorur nga Bota Sot dhe kanali me “ish-zyrtarin e lartë”;
- hash-i, dimensionet dhe metadata e skedarit të dërguar më 5 gusht 2025;
- provë e pavarur që lidh CIA-n, BIA-n ose një institucion tjetër me krijimin e fotografisë, jo vetëm me posedimin e një kopjeje.

14.2 Kufizime që mbeten të hapura

Raporti mbështetet vetëm në materiale publike dhe të datuara. Për arsyet e mospërdorimit të kërkesave individuale për koment dhe për procedurën e së drejtës së përgjigjes, shih J.3.

15. Përfundimi

Nga gushti 2018 deri në gusht 2026 u shtuan bartës, përkthime, tituj, autoritet politik, pretendime të reja për prejardhjen, një debat televiziv dhe, në fund, një kontekst penal. Ajo që nuk u shtua kurrë publikisht ishte identifikuesi themelor i objektit: kush e shkroi, kur u krijua, për cilin institucion, në cilin skedar dhe përmes cilit zinxhir arriti deri te publikimi i parë.

Kjo nuk e bën fotografinë të parëndësishme. Ajo ka rëndësi si objekt qarkullimi, si instrument argumenti dhe si material që, sipas aktakuzës, u përdor edhe në komunikim privat. Por relevanca nuk është autenticitet, ndërsa posedimi nuk është provë e krijimit.

Modeli që mbështetet më së miri nga evidenca publike është më i thjeshtë: një objekt me prejardhje të panjohur hyri në qarkullim, mori përkthime dhe interpretime të ndryshme, humbi gradualisht historinë e burimit dhe fitoi peshë nga bartës gjithnjë e më autoritativë. Dosja e vitit 2026 e bëri përsëri relevante fotografinë; nuk e zgjidhi prejardhjen e saj.

THELBI I GJETJEVE

Fotografia nuk u trajtua si dokument sepse iu provua origjina, por sepse bartësit e saj kishin gjithnjë e më shumë autoritet.

Ndërkohë, xhamitë, praktika fetare dhe vetë prania myslimane nisën të përdoren si “prova” të planit që fotografia pretendonte të zbulonte duke e kthyer një pretendim të paverifikuar në një rreth që vërteton vetveten.

Tabelat e plota të nyjeve, personave dhe skedarëve, transkriptimi, përkthimi literal, kontrolli negativ dhe regjistri i URL-ve gjenden në **Pjesën II** të raportit

PJESA II

LIBRI I PROVAVE

Regjistri i skedarëve, nyjeve, përkthimeve, kontrolleve dhe burimeve të auditueshme.

PARIMI

Pjesa narrative shpjegon trajektoren. Libri i provave ruan materialin që i lejon lexuesit ta kontrollojë trajektoren dhe gjetjet.

A. Rregulli i evidencës dhe integriteti i të dhënave hyrëse

PARIMI

Libri i provave nuk përsërit argumentin narrativ. Ai mban gjurmët që lejojnë një lexues të kontrollojë se nga vjen një datë, një titull, një hash ose një atributim.

- Fakt i drejtpërdrejtë: shihet në imazh, HTML, metadata, PDF ose ekspozitë lokale të ruajtur.
- Pretendim i burimit: provohet se është thënë; nuk provohet automatikisht se është i vërtetë.
- Inferencë: del nga kronologjia ose gjurma e kopjimit dhe shoqërohet me kufirin e vet.
- Publikim i hershëm nuk quhet automatikisht publikim i parë. Posedimi nuk barazohet me krijimin. Shumë artikuj nuk barazohen me shumë burime.

B. Artefakti dhe krahasimi i kopjeve

Top Secret 2

Kad postignemo dogovor sa nasim operativcima dole na Kosmet, skupljane fondova od Islamskih ambasada u Beogradu mozemo da prenesemo dole, najveći deo fondova treba da se investira za gradnju dzamija. Mesta za gradnju dzamija treba da pronadjemo na sto vidliva mesta blizu autoputa, skola, gradskih centara. Dzamije u velikim selima treba da se dvostruce i trostruce.

Pored dzamija, islamkse skole (medrese) treba da se sire svugdje i na tim mestima gdje nema interesovanja treba da se prenesu deca i mladih od mesta gdje islam ima veci znacaj nego nacija, kao sto su delovi Mitrovice, Vucitrna, General Jankovic, Kacanik, Dragas, Prizren.

Pored siptarskih operativaca veliki doprinos ce dati nasi ljudi iz Makedonije, Bosne i Sandjaka, uzeci u obzir i Rome i Cigane koji su spremni da rade za nas i da se uljuce aktivno u islam.

Poglavari Islamskih zajednica Srbije, Makedonije, Kosmeta, i Bosnie su pod nasom kontrolom i rade da sto vise ukljuce ljude koji su popularni i uticajni u siptarskim sredinama iz sporta, muzike, media i politike. U nekim znacajnim siptarskim politickim partijama vec imamo ljude koji rade za nas i snazno podrzavaju islam, i vezani su sa glavarima koji sire islam u delovima gdje islama i dzamije nije imalo nikada.

U zapadnim zemljama su delegirani nasi ljudi is islamke zajdenice Kosmeta i Sandjaka koji su pod nadzorom nasih ambasada Svajcarske, Njemacke, Belgije. S time cemo znajcanjno uspeti da podelimo siptare u inostranstvo uglanom Svajcarska i Njemacka su znacajne tu su najbogatiji i najmocniji siptari koji su podrzali Rugovu.

Dole na Kosmetu treba da se stvara atmosfera da se ljudi osecaju kao da zive u tudju zemlju, sa time deo omladine ce da izbegne u inostranstvo, i jedan deo ce da se opredeli za islam. Za 20 godina deo Kosmeta izgleda ce kao Kandahar. Zapadne sile ce polako meriti misljenje za siptare i tako ce da se opredele za vracanje Kosmeta pod nadzorom Srbije.

Kad se to postize, Srbija ce imati slobodne ruke da ponovi akciju proterivanja siptara u Tursku ovaj put ne sa silom ali privlačenjem preko verskih poglavara za zaposlenje, obećavanje ekstra uslova za migraciju u Tursku. Za to Srbija ima zeleno svetlo od Turske drzave.

Figura B1. Kopja publike 720×1017 px e përdorur për transkriptim; nuk është skedar burimor.

Top Secret 2

Kad postignemo dogovor sa nasim operativcima dole na Kosmet, skupljane fondova od Islamskih amabsada u Beogradu mozemo da prenesemo dole, najveci deo fondova treba da se investira za gradnju dzamija. Mesta za gradnju dzamija treba da pronadjemo na sto vidлива mesta blizu autoputa, skola, gradskih centara. Dzamije u velikim selima treba da se dvostruce i trostruce.

Pored dzamija, islamkse skole (medrese) treba da se sire svugdje i na tim mestima gdje nema interesovanja treba da se prenesu deca i mladih od mesta gdje islam ima veci znacaj nego nacija, kao sto su delovi Mitrovice, Vucitrna, General Jankovic, Kacanik, Dragas, Prizren.

Pored siptarskih operativaca veliki doprinos ce dati nasi ljudi iz Makedonije, Bosne i Sandjaka, uzeci u obzir i Rome i Cigane koji su spremni da rade za nas i da se uljuee aktivno u islam.

Poglavari islamskih zajednica Srbije, Makedonije, Kosmeta, i Bosnie su pod nasom kontrolom i rade da sto vise ukljuee ljude koji su popularni i uticajni u siptarskim sredinama iz sporta, muzike, media i politike. U nekim znacajnim siptarskim politickim partijama vec imamo ljude koji rade za nas i snazno podrzavaju islam, i vezani su sa glavarima koji sire islam u delovima gdje islama i dzamije nije imalo nikada.

U zapadnim zemljama su delegirani nasi ljudi is islamke zajednice Kosmeta i Sandjaka koji su pod nadzorom nasih ambasada Svajcarske, Njemacke, Belgije. S time cemo znajcanjno uspeti da podelimo siptare u inostranstvo uglanom Svajcarska i Njemacka su znacajne tu su najbogatiji i najmocnih siptari koji su podrzali Rugovu.

Dole na Kosmetu treba da se stvara atmosfera da se ljudi osecaju kao da zive u tudju zemlju, sa time deo omladine ce da izbegne u inostranstvo, i jedan deo ce da se opredeli za islam. Za 20 godina deo Kosmeta izgleda ce kao Kandahar. Zapadne sile ce polako menjati misljenje za siptare i tako ce da se opredele za vracanje Kosmeta pod nadzorom Srbije.

Kad se to postize, Srbija ce imati slobodne ruke da ponovi akciju proterivanja siptara u Tursku ovaj put ne sa silom ali privlacenjem preko verskih poglavara za zaposlenje, obecavanje ekstra uslova za migraciju u Tursku. Za to Srbija ima zeleno svetlo od Turske drzave.

Figura B2. Kopje e prerë / e zmadhuar e së njëjtës familje tekstuale.

Figura B1. Kopja publike e artefaktit. 720×1017 px; SHA-256 i kopjes së futur në korpus:

44168e1bb8953465957f34713ef2d09776940478da78589c131267a7b7817430

Figura B2. Crop i së njëjtës familje tekstuale. 672×802 px; SHA-256: 39098941d74f6e35683ab891e5f2394a004ffd6b05b21ebcc78744afbea5b5cf

Elementi	Vëzhgimi	Statusi
Titulli	"Top Secret 2"	I dukshëm
Watermark	"CONFIDENTIAL" diagonal	I dukshëm në kopjen publike

Elementi	Vëzhgimi	Statusi
Institucioni lëshues	Nuk shihet	Mungesë
Data / protokolli	Nuk shihen	Mungesë
Autor / marrës / nënshkrim	Nuk shihen	Mungesë
Numër faqeje / total	Nuk shihet	Mungesë

Elementi	Vëzhgimi	Statusi
Skedar burimor / metadata krijimi	Nuk u rikuperuan	Mungesë kritike

Standardi serb përdoret vetëm si krahasim formal. Ligji dallon TOP SECRET nga CONFIDENTIAL dhe kërkon elemente të administrimit që nuk duken në kopjen publike. Burimet zyrtare: R166 dhe R167.

B.1 Burimet zyrtare serbe të krahasimit

Krahasimi formal mbështetet në Ligjin për fshehtësinë e të dhënave, Rregulloren për shënimin e dokumenteve, Udhëzuesin zyrtar të zbatimit 2026 dhe modelet e publikuara nga Zyra e Këshillit për Siguri Kombëtare dhe Mbrojtjen e të Dhënave të Fshehta. [R166-R178]

Kërkesa / praktika	Burimi zyrtar	Kopja publike	Vlera
Një nga katër nivelet	Ligji, nenet 14-15	"Top Secret 2" + "CONFIDENTIAL"	Dy nivele të ndryshme, nëse të dyja janë klasifikim.
Organi dhe personi i autorizuar	Ligji, neni 13	Nuk shihen	Nuk rindërtohet vendimi institucional.
Data dhe mbarimi i sekretit	Ligji + Rregullorja, neni 6	Nuk shihen	Nuk ka pikënisje zyrtare.
Shenja në pozicion të standardizuar	Rregullorja, nenet 2-3	Titull i vogël + watermark diagonal	Pamja nuk ndjek modelin e dukshëm zyrtar.
Faqja X nga Y / kopjet / shtojcat	Rregullorja, neni 6	Nuk shihen	Nuk dihet integriteti i faqes.
Shënimi i kopjes dhe regjistri	Rregullorja, neni 7	Nuk shihen	Nuk gjurmohet shumëzimi/dorëzimi.
Vendim formal + vlerësim dëmi	Udhëzuesi 2026	Nuk publikohen	Pretendimi i klasifikimit nuk ka dokument shoqërues.

B.2 Red-team i krahasimit formal

Një shërbim mund të prodhojë draft, shënim pune ose material joformal që nuk ndjek çdo formular. Fotografia mund të jetë faqe e prerë dhe watermark-u mund të jetë shtuar pas krijimit. Për këtë arsye, mospërputhjet nuk përdoren si verdikt absolut. Ato përdoren për të vendosur barrën e provës: sa më pak identifikues të ketë faqja, aq më shumë duhet një zinxhir i jashtëm që ta autentikojë.

C. Transkriptimi dhe përkthimi literal

C.1 Transkriptimi diplomatik

Kad postignemo dogovor sa nasim operativcima dole na Kosmet, skupljane fondova od Islamskih ambasada u Beogradu mozemo da prenesemo dole, najveci deo fondova treba da se investira za gradnju dzamija. Mesta za gradnju dzamija treba da pronadjemo na sto vidljiva mesta blizu autoputa, skola, gradskih centara. Dzamiye u velikim selima treba da se dvostruse i trostruse.

Pored dzamija, islamske skole (medrese) treba da se sire svugde i na tim mestima gdje nema interesovanja treba da se prenesu deca i mladih od mesta gdje islam ima veci znacaj nego nacija, kao sto su delovi Mitrovice, Vucitna, General Jankovic, Kacanik, Dragas, Prizren. Pored siptarskih operativaca veliki doprinos ce dati nasi ljudi iz Makedonije, Bosne i Sandjaka, uzeci u obzir i Rome i Cigane koji su spremni da rade za nas i da se ukljuce aktivno u islam.

Poglavari islamskih zajednica Srbije, Makedonije, Kosmeta, i Bosne su pod nasom kontrolom i rade da sto vise ukljuce ljude koji su popularni i uticajni u siptarskim sredinama iz sporta, muzike, media i politike. U nekim znacajnim siptarskim politickim partijama vec imamo ljude koji rade za nas i snazno podrzavaju islam, i vezani su sa glavarima koji sire islam u delovima gdje islama i dzamije nije imalo nikada.

U zapadnim zemljama su delegirani nasi ljudi iz islamske zajednice Kosmeta i Sandjaka koji su pod nadzorom nasih ambasada Svajcarske, Njemacke, Belgije. S time cemo znacajno uspeti da podelimo siptare u inostranstvu uglavnom Svajcarska i Njemacka su znacajne tu su najbogatiji i najmocniji siptari koji su podrzali Rugovu.

Dole na Kosmetu treba da se stvara atmosfera da se ljudi osecaju kao da zive u tudju zemlju, sa time deo omladine ce da izbegne u inostranstvo, i jedan deo ce da se opredeli za islam. Za 20 godina deo Kosmeta izgleda ce kao Kandahar. Zapadne sile ce polako menjati misljenje za siptare i tako ce da se opredele za vracanje Kosmeta pod nadzorom Srbije.

Kad se to postize, Srbija ce imati slobodne ruke da ponovi akciju proterivanja siptara u Tursku ovaj put ne sa silom ali privlacenjem preko verskih poglavara za zaposlenje, obecavanje ekstra uslova za migraciju u Tursku. Za to Srbija ima zeleno svetlo od Turske drzave.

Shënim: "siptar/siptari" është term pejorativ në serbisht; "Kosmet" është emërtim politik serb për Kosovë e Metohi. Format "amabsada", "dvostruse", "na sto vidljiva", "deca i mladih", "u tudju zemlju", "izgleda ce" dhe të tjera ruhen siç shfaqen.

SAKTËSIA E TRANSKRIPTES

Transkriptimi është diplomatik: format e burimit ruhen ashtu siç shfaqen, përfshirë gabimet ("amabsada", "dvostruse", "na sto vidljiva", "deca i mladih", "u tudju zemlju", "izgleda ce"). Asnjë formë nuk është normalizuar. Nëse një formë nuk lexohet qartë në kopjen publike, kjo shënohet me [?] dhe nuk zëvendësohet me hamendje. Ky rregull është i domosdoshëm: pikërisht këto forma janë objekt i analizës në C.4 dhe C.6, dhe një transkriptim i "pastruar" do ta shkatërronte provën që raporti pretendon ta ruajë.

C.2 Përkthimi literal në aktakuzën e Prokurorisë Speciale

"Pasi që të bëjmë marrëveshje me operativet tanë në Kosmet, mbledhjen e fondeve nga ambasadat islamike në Beograd shumica e këtyre parave do të investohen në ndërtimin e xhamive. Xhamitë duhet të ndërtohen në vende të dukshme si afër auto udhëve, shkollave, qendrave tregtare ndërsa xhamitë në fshatrat e mëdha duhet të dyfishohen dhe trefishohen"

Pranë xhamive, shkollat islamike (mdereset) duhet të shtrihen në të gjithë vendin edhe në ato vende ku interesimi është më i vogël, fëmije dhe të rritur duhet të barten nga vendet ku feja është më e rëndësishme se kombi si nga vendet Mitrovicë, Vushtrri, Djeneral jankovic, Kaqanik, Dragash dhe Prizren. Krahas operativëve Shqiptar kontribut të madh do të japin edhe njerëzit tanë nga Maqedonia, Bosnja dhe Sanxhaku duke përfshirë Romët dhe Ciganet të cilët janë të gatshëm të punojnë për ne dhe të aktivizohen në Islam.

udhëheqsit e bashkësive islamike të Serbisë, Maqedonisë, Bosnes, Kosmetit janë nën kontrollin tonë dhe po punojnë që sa më shumë të inkuadrojnë njerëz me kombësi Shqiptare me ndikim në Sport, media muzike dhe politike. Edhe në disa parti politike kemi njerëzit tanë të cilët punojnë për ne dhe të cilët e përkrahin fuqishëm islamin dhe të cilët janë të lidhur me udhëheqsit islam të cilët janë duke shpërndarë islamin edhe në vendet ku nuk ka pasur kurrë xhami. Në vendet përëndimore janë deleguar njerëzit tanë nga bashkësitë islame nga Kosova dhe Sanxhaku të cilët janë nën urdhrat e ambasadave tona në Zvicër, Gjermani dhe Belgjike. Me këtë do të arrijmë që ti ndajmë Shqiptarët të cilët jetojnë jashtë shteti kryesisht në Zvicër dhe Gjermani ku jetojnë Shqiptarët më të pasur dhe me të fuqishëm të cilët e kanë përkrahur Rugovën.

Poshtë në Kosmet duhet të krijohet atmosfera ashtu që njerëzit të ndjehen sikur po jetojnë në një shtet të huaj kështu që një pjesë e rinisë do të ikë jashtë Kosovës dhe një pjesë do të vendosin për fenë islame. Pas 20 viteve Kosova do të duket si Kandahar. Fuqitë perendimore do të ndryshojnë mendimin për Kosovën dhe kështu do të vendosin për kthimin e Kosovës nën juridiksionin e Serbisë. Kur kjo të arrihet Serbia do të ketë duart e lira të përsëris përndjekjen e Shqiptareve në Turqi mirëpo këtë herë jo përmes forcës por përmes udhëheqsve fetarë për punësim dhe duke ju ofruar super kushte për migrim në Turqi. Për këtë Serbia ka dritën jeshile nga shteti i Turqisë".

C.3 Mutacionet kryesore të transmetimit

Teksti / ideja burimore	Forma e transmetuar	Vlera analitike
"deo Kosmeta"	"Kosovën"	Zgjerim nga një pjesë të gjithë territori.
"izgleda ce kao Kandahar"	"duhet ta bëjmë si Kandaharin"	Parashikim i parregullt kthehet në urdhër.
"naši ljudi"	"njerëzit tanë (të UDB-së dhe BIA-s)"	Selatin shton identifikim institucional në kllapa.
"Rome i Cigane"	"Romët dhe Hashkalinjtë"	Shenjë e degës Selatin/Ulpiana.
kushte migrimi/punësimi në Turqi	"shtëpi luksoze, transport komod dhe modern"	Zgjerim që nuk shihet në faqen serbisht.
titulli i Bota Sot	"Për 20 vite është e jona"	Fjali që nuk gjendet në artefakt.

C.4 Regjistri i anomalive gjuhësore

Kategoria	Forma e burimit	Problemi	Si u transmetua	Pesha e provës
Typo	amabsada	Rend i gabuar shkronjash	"ambasadat"	Fingerprint i humbur në përkthim.
Rasa	deca i mladih	Mospajtim në rasë	"fëmijë dhe të rinj"; KALLXO: "të rritur"	Redaktim + ndryshim grupmoshe në një degë.
Pajtim	najbogati i najmocnih siptari	Mospajtim mbiemër-emër	"më të pasur dhe më të fuqishëm"	Gramatika riparohet.
Parafjala	na sto vidljiva mesta	Ndërtim jo standard	"në vende sa më të dukshme"	Paqartësia bëhet urdhër i pastër.
Folja	džamije treba da se dvostruke i trostruke	Formë jo e rregullt	"numri i xhamive duhet të dyfishohet..."	Ndryshohet edhe subjekti.

Kategoria	Forma e burimit	Problemi	Si u transmetua	Pesha e provës
Kolokacion	ukljuce aktivno u islam	Shprehje e panatyrshme	"përfshihen aktivisht në Islam"	Kalku bëhet formulim i rrjedhshëm.
Sintaksë	islama i dzamije nije imalo nikada	Pajtim/rend jo natyral	"ku nuk kishte Islam dhe xhami"	Shenja e redaktimit zhduket.
Kohë	deo Kosmeta izgleda ce kao Kandahar	Kohë dhe rend i çrregullt	"Kosova do të duket si Kandahar"	Riparohet koha dhe zgjerohet territori.
Aspekt	Kad se to postize	Aspekt i papërshtatshëm	"Kur kjo të arrihet"	Teksti fiton logjikë të pastër.

Kategoria	Forma e burimit	Problemi	Si u transmetua	Pesha e provës
Semantikë	gradskih centara	Qendra qytetesh	"qendra tregtare"	Përkthim i pasaktë me efekt të ri vizual.
Semantikë juridike	pod nadzorom Srbije	Kontroll/mbikëqyrje	"nën juridiksionin e Serbisë"	Pretendimi bëhet më formal/juridik.
Atribuim	naši ljudi	Njerëzit tanë	"të UDB-së dhe BIA-s"	Institucioni futet nga përkthyesi.
Dialekt	mesto/deca + gdje/svugdje/Njem ačke	Ekavishte + ijekavishte	Përkthimi e unifikon	Përzjerja mbetet vetëm në imazh.

C.5 Struktura e tekstit kundrejt një vlerësimi formal

Elementi	Çka pritet në një vlerësim të redaktuar	Çka ka faqja
Subjekti / marrësi	Njësi, autor, marrës ose kontekst dosjeje	"Ne" pa identifikim.
Burimet	Burim, nivel besimi, kufizim ose corroboration	Asnjë burim i emërtuar.
Objektivat	Masa konkrete, aktorë, lokacione, afate	Synime totale pa përgjegjësi.
Burimet operative	Emra/kode, kapacitet, detyrë, raportim	"operativët tanë" dhe "njerëzit tanë".
Buxheti / logjistika	Shuma, kanale, aprovime, risk	"fondet" pa shifra ose mekanizëm.
Rezultati / indikatorët	Kriter matjeje dhe dështimi	"Kandahar", Perëndimi largohet, dëbim.
